



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr.61/2019 regjistër (JR)  
Datë 10.12.2019

Nr. 24 i vendimit  
Datë 28.07.2021

**VENDIM**  
**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Ardian Hajdari</b>	<b>Kryesues</b>
<b>Ina Rama</b>	<b>Relatore</b>
<b>Albana Shtylla</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Sokol Çomo</b>	<b>Anëtar</b>

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 28.07.2021, ditën e mërkurë, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Theo Jacobs, me Sekretare Gjyqësore Adelajda Hiska, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket:

**ANKUES:** Subjekti i rivlerësimit Luan Hasneziri, gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda Tiranë.

**OBJEKTI I ANKIMIT :** Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 170, datë 26.06.2019.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 4, pika 1, 22, pika 1, 42, pika 1, 43, 142, pika 1 dhe 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut; Parimet themelore mbi pavarësinë e gjyqësorit, të miratuara nga Kongresi VII i Kombeve të Bashkuara; Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut; vendimet e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë nr. 34/2005; nr. 10 /2008; nr. 9/2010; nr. 20/2011; nenet 1, 4, 30-44, 45, 52, 55, 57, 61, 62, 63, 65 dhe 66 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; Kodi i Procedurave Administrative; nenet 47, 48, 49, 51 dhe 55 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

## Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, (në vijim “ligji 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e kërkimet e subjektit të rivlerësimit të paraqitura në ankim dhe parashtrimet para seancës, dëgjoji relatoren e çështjes, gjyqtaren Ina Rama, si dhe pasi e bisedoi atë,

### VËREN:

#### I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Luan Hasneziri, në momentin e hyrjes në fuqi të nenit 179/b të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, të miratuar me anë të ligjit nr. 76, datë 22.07.2016, mbante detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda, Tiranë dhe, për shkak të këtij funksioni dhe zbatimit të nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, ai i është nënshtuar procesit të rivlerësimit *ex-officio* nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”). Në funksion të hetimit administrativ, Komisioni ka administruar raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”).

1.1 ILDKPKI-ja, pasi ka kryer procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, bazuar në nenin 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, i ka dërguar Komisionit raportin përfundimtar<sup>1</sup>, duke konstatuar se:

- (i) deklarimi nuk është i saktë, në përputhje me ligjin;
- (ii) nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë për të ardhurat e huadhënësve;
- (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- (iv) nuk ka kryer deklarim të rreme;
- (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

1.2 DSIK-ja i dërgoi Komisionit raportin e kontrollit të figurës<sup>2</sup>, bazuar në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, duke konstatuar papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit Luan Hasneziri.

#### II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

2. Me vendimin nr. 170, datë 26.06.2019, Komisioni vendosi shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Luan Hasneziri, gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda Tiranë. Vendimi është marrë nga Komisioni bazuar në vlerësimin e dy kriterëve, përkatësisht të kontrollit të pasurisë dhe të figurës së subjektit të rivlerësimit. Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, Komisioni lidhur me këto dy kriterë vlerësimi ka konkluduar si vijon.

##### 2.1 Lidhur me kontrollin e kriterit të pasurisë

- i. Subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur prova, të cilat të provojnë burimin e ligjshëm dhe realizimin e të ardhurave për krijimin e pasurisë apartament, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe, rrjedhimisht, subjekti ka bërë deklarim të pamjaftueshëm për kontrollin e pasurisë.
- ii. Subjekti nuk ka pasur burime të ligjshme të të ardhurave për të krijuar pasurinë e analizuar në vitin 2006 dhe për të bërë shpenzime, duke rezultuar me një bilanc negativ, në vlerën 4.786.638 lekë.
- iii. Subjekti, në bazë dhe në zbatim të ligjit nr. 9049/2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, ka kryer deklarim

<sup>1</sup> Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 17.07.2018.

<sup>2</sup> Me shkresën e datës 02.11.2017 (të deklasifikuar plotësisht me vendimin e KDZH-së, datë 07.02.2019).

të pamjaftueshëm të kursimeve cash në deklaratat periodike të viteve 2003 dhe 2004, si dhe në deklaratën “vetting”.

iv. Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm, pasi nuk ka deklaruar të drejtën reale të përdorimit të automjetit në pronësi të z. B. H. në deklaratat e interesave privatë vjetorë periodikë (në vijim “DVP”) të viteve 2013, 2014, 2015 dhe 2016, sipas germës “a” të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”.

v. Subjekti rivlerësimit Luan Hasneziri nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë së tij dhe të personave të lidhur (sipas parashikimeve të paragrafëve 1 dhe 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës).

vi. Subjekti rivlerësimit Luan Hasneziri, nuk ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë.

## **2.2 Lidhur me kontrollin e kriterit të figurës**

Subjekti i rivlerësimit Luan Hasneziri arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016, pasi nga verifikimet e kryera, nuk rezultoi se ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ka dorëzuar në kohë deklaratën për figurën, si dhe ka bërë deklarime të pasakta të cilat nuk janë në nivelin e një shkaku ligjor për shkarkim ose nuk ka fshehur kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

3. Në përfundim, mbështetur në pikën 1, të nenit 59, të ligjit nr.84/2016, Komisioni arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, nuk ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas germës “a”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr.84/2016, duke vendosur dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

## **III. Shkaqet e ankimit**

4. Subjekti i rivlerësimit Luan Hasneziri ka ushtruar ankim<sup>3</sup> kundër vendimit të Komisionit nr. 170, datë 26.06.2019, me anë të të cilit ka pretenduar se ky vendim i Komisionit është absolutisht i pavlefshëm, është marrë në shkelje të parimeve të procesit të rregullt ligjor e procedurave, pa analizuar provat e paraqitura prej tij.
5. Në ankim, subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka kryer “disa” shkelje të rënda procedurale dhe materiale, që vijnë në kundërshtim me Kushtetutën dhe me ligjin nr. 84/2016, që kanë të bëjnë me zhvillimin e procedurës së gjyqimit, mënyrën e arsytimit, analizën e fakteve dhe rrethanave të dala gjatë gjyqimit, gjuhën e përdorur në arsytimin e vendimit dhe logjikën e gabuar në arritjen e përfundimeve, duke cenuar rëndë të drejtën e tij për një proces të rregullt ligjor.
6. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit për shkelje të procesit të rregullt ligjor dhe procedurave gjatë gjyqimit në Komision, në mënyrë të përmbledhur, janë si vijon.

**6.1** Komisioni ka filluar procedimin administrativ pa administruar raportet e organeve ndihmëse, duke i mohuar subjektit të drejtën për një mbrojtje efektive dhe për t’u njohur me të gjitha aktet që kanë të bëjnë me procesin e tij të rivlerësimit, rrethana që përbëjnë shkaqe të mjaftueshme që vendimi i Komisionit, në zbatim të shkronjës “a” të nenit 108 të Kodit të Procedurave Administrative, të konstatohet nga Kolegji si një akt absolutisht i pavlefshëm.

**6.2** Komisioni ka rrëzuar kërkesën për riçeljen e hetimit administrativ në lidhje me kontrollin e aftësive profesionale duke mos i njoftuar subjektit arsyet e rrëzimit të kësaj kërkesë para seancës dëgjimore publike, rrethanë që përbën cenim të së drejtës për t’u mbrojtur, paragjykim të hapur të

<sup>3</sup> I regjistruar në Komision me nr. {\*\*\*} prot., datë 27.11.2019.

çështjes dhe shkeljen e parimit të pavarësisë dhe paanësisë. Vendimi i marrë nga trupi tjetër gjykues që ka shqyrtuar kërkesën për përjashtimin e trupës gjykuese të Komisionit që ka kryer procesin e tij të rivlerësimit, nuk u ka dhënë asnjë përgjigje pretendimeve dhe argumenteve të kësaj kërkesë.

**6.3** Procedura e hetimit administrativ në Komision, e cila ka filluar, vazhduar dhe përfunduar nga të njëjtët anëtarë të trupit gjykues që kanë dhënë edhe vendimin përfundimtar objekt shqyrtimi, përbën shkelje flagrante të parimit të paanësisë të garantuar nga Kushtetuta dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

**6.4** Vendimi i Komisionit që ka dhënë për subjektin e rivlerësimit masën disiplinore të shkarkimit nga detyra ka cenuar parimin e paanësisë dhe të pavarësisë pasi nuk është marrë nga një gjykatë e caktuar me ligj, siç kërkon neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Karta Evropiane mbi Statusin e Gjyqtarëve.

**6.5** Kalimi i barrës së provës subjektivit të rivlerësimit nga Komisioni, është bërë në kundërshtim të hapur me përcaktimet e nenit D, pikat 4 e 5 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, pasi subjekti ka dorëzuar deklaratën *vetting*, e se nuk u provua se ka më shumë se 2-fishi i pasurisë së ligjshme e as u provua se është përpjekur të fshehtë e paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi.

**6.6** Komisioni nuk ka vlerësuar, analizuar dhe shpjeguar/arsyetuar në vendim aktet e paraqitura në cilësinë e provës nga subjekti përgjatë hetimit, si dhe përgjatë seancës dëgjimore.

**7. Lidhur me pretendimet për themelin e gjykimit, subjekti i rivlerësimit parashtron në mënyrë të përmbledhur se:**

**7.1** Komisioni ka kryer shkelje ligjore lidhur me vlerësimin e gabuar të gjendjes faktike për pasurinë e paluajtshme banesë në rrugën “{\*\*\*}”<sup>4</sup>, me sip. 135 m<sup>2</sup>, Tiranë, që lidhen me:

- i. Moskonsiderimin e kontratës së shitblerjes së kësaj prone si të lidhur në rrethana të veçanta, ku të dy palët njiheshin dhe kishin besim te njëri-tjetri, të cilët kishin një marrëdhënie të posaçme për të cilën duhet të gjente aplikim neni 232, shkronja “ç” e Kodit Civil.
- ii. Pranimin si alternativë e vetme për pagimin totalisht të çmimit të kësaj pasurie të paluajtshme, të versionit që në mënyrë formale parashikon kontrata e shitblerjes: *se çmimi është paguar para lidhjes së kontratës jashtë zyrës noteriale*, çka e ka çuar Komisionin në përfundim të gabuar, pasi ky është një fakt i pavërtetë.
- iii. Qëndrimi i Komisionit se nëse pranojmë alternativën e paraqitur nga subjekti për pagimin e kësaj prone, sërish ai rezulton me situatë financiare negative, me (-) 386 638 lekë, nuk është i saktë, pasi kjo diferencë, bazuar në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit, nuk duhet të përbëjë shkak për shkarkimin nga detyra
- iv. Përlllogaritja e shpenzimeve të jetesës nga Komisioni për vitin 2006 është e gabuar pasi bazohet në të dhëna jo të sakta.

**7.2** Konkluzioni i Komisionit lidhur me të ardhurat e ligjshme të vëllait, është i gabuar pasi:

- i. Me provat e paraqitura, ka mundur të provojë burimin e ligjshëm të të ardhurave të të vëllait, A. H., të cilat ia ka dhënë hua në vitin 2007 dhe konkluzioni i Komisionit është i padrejtë, pasi subjekti pretendon se aktet që ka paraqitur përbëjnë indicie të plota që provojnë faktin se personi tjetër i lidhur (vëllai), këto të ardhura i ka krijuar nga puna e tij si emigrant në Greqi.
- ii. Referuar përcaktimeve ligjore, ligjshmëria e pasurisë lidhet me burimin e krijimit të saj dhe jo me pagesën e tatimit mbi këto të ardhura.

---

<sup>4</sup> *Ish-rruga “{\*\*\*}”.*

7.3 Konkluzionet e Komisionit se ka kryer shkelje administrative apo disiplinore pasi nuk arriti të provojë mënyrën e pagimit të çmimit të apartamentit, vijnë në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike.

7.4 Komisioni ka kryer shkelje ligjore që lidhen me vlerësimin e gabuar të gjendjes faktike lidhur me përdorimin e mjetit Benz {\*\*\*} pasi:

- i. Kushtetuta e ka lidhur drejtpërdrejt përgjegjësinë e subjektit të rivlerësimit me deklaratën *vetting* dhe jo deklaratimet në deklarata periodike kur, ndërkohë, në rastin konkret, rezultoi se subjekti ka deklaruar në deklaratën *vetting* përdorimin e këtij automjeti.
- ii. Burimi i ligjshëm i të ardhurave të personit tjetër të lidhur B. H. që kanë shërbyer për blerjen e këtij automjeti provohet nga aktet e dorëzuara prej subjektit përgjatë hetimit administrativ. Ndërsa për të vërtetuar pagesën e tatimit lidhur me këto të ardhura, subjekti pretendon se e ka të pamundur nga pikëpamja objektive, pasi personi tjetër i lidhur ka punuar në emigracion jo në mënyrë të ligjshme, ndërsa për të ardhurat e fituara prej tij nga toka bujqësore duhet të gjejë aplikim neni 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

7.5 Komisioni ka kryer shkelje ligjore që lidhen me vlerësimin e gabuar të gjendjes faktike për gjendjen e likuiditeteve në *cash* pasi:

- i. Mosdeklarimi i kursimeve në *cash* nga ana e subjektit për vitet 2003 e 2004 në deklaratat vjetore periodike ka ndodhur për shkak të moskuptimit të këtyre deklaratave.
- ii. Duke qenë se shumata e deklaruara si kursime *cash* në DVP kanë gabime dhe pasaktësi, si shumë e kursyer prej subjektit deri në vitin 2016 duhet të konsiderohet shuma e deklaruar në deklaratën *vetting*.

7.6 Komisioni ka kryer vlerësim të gabuar të gjendjes së faktit për detyrimin financiar ndaj shtetasit R. K., pasi gjatë hetimit administrativ në Komision dhe në seancë dëgjimore, subjekti pretendon se ka paraqitur të gjithë dokumentacionin e mundshëm, në formën e kërkuar nga ligji, që provon se ky shtetas i ka dhënë këtë hua, të cilën e ka siguruar nga puna e tij e rregullt në Greqi.

7.7 Subjekti i rivlerësimit pretendon se dhënia e masës disiplinore të shkarkimit të tij nga detyra është ndikuar nga roli i tij aktiv në qëndrimin që ka mbajtur lidhur me reformën në drejtësi, si dhe nga emisionet e medias vizuale të cilat kanë pasqyruar së shumti qëndrimet oponente të tij për reformën në drejtësi.

8. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit, me ankimin e tij, ka kërkuar nga Kolegji: **(i)** Konstatimin absolutisht të pavlefshëm të vendimit nr. 170, datë 26.06.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. **(ii)** Kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore publike. **(iii)** Marrjen në shqyrtim, për herë të parë, si gjykatë e shkallës së parë, nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, të akteve dhe provave që kanë të bëjnë me të tria kriteret e vlerësimit: pasuri, figurë dhe aftësi profesionale e etike dhe, pas shqyrtimit të tyre, arritjen në përfundimin për një nivel të besueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, për një nivel të besueshëm për kriterin e kontrollit të figurës dhe për një nivel të besueshëm për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale e etike. **(iv)** Konfirmimin në detyrë si gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë.

9. Subjekti i rivlerësimit, së bashku me ankimin, ka paraqitur disa akte të cilat ka kërkuar të merren me cilësinë e provës prej Kolegjit<sup>5</sup>. Subjekti i rivlerësimit paraqiti gjithashtu parashtime me shkrim dhe

---

<sup>5</sup> Aktet bashkëlidhur ankimit:

- *Njoftim i kryer nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, i datës 16.1.2019.*
- *Njoftim i kryer nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, i datës 06.02.2019.*
- *Kërkesë e bërë prej subjektit, drejtuar Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, datë 16.5.2019.*
- *Përgjigje e kthyer nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit më datë 17.5.2019, ora 3:15 PM.*
- *Përgjigje e kthyer prej subjektit Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, më datë 17.5.2019, ora 3:33 PM.*

akte shoqëruese<sup>6</sup> lidhur me shkaqet e ngritura në ankim në përputhje me afatin 5-ditor para zhvillimit të seancës gjyqësore në dhomë këshillimi në Kolegj, në përputhje me parashikimin e nenit 49 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” (në vijim “ligji nr. 49/2012”) Në përfundim të tyre, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar të njëjtat kërkitime si ato të ankimit lidhur me pavlefshmërinë absolute të vendimit të Komisionit, ose prishjen e këtij vendimi dhe konfirmimin e tij në detyrë.

#### IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit

##### A. Procesi gjyqësor dhe aspektet procedurale të gjykimit

###### a) Juridiksioni i Kolegjit

10. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur dhënien e masës disiplinore për subjektin Luan Hasneziri dhe për të cilin subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet ankimit, kërkon ndryshimin e tij, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

###### b) Legjitimitimi i ankuesit

11. Subjekti i rivlerësimit legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis* pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh, nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

###### c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

12. Në përputhje me nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, si rregull, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankohet nga subjekti i rivlerësimit, kryhet në dhomë këshillimi. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit të Komisionit nr. 170, datë 26.06.2019, bazuar në ankimin e subjektit të rivlerësimit Luan Hasneziri, u mor në shqyrtim nga Kolegji në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi.

- 
- Një kopje e CD-së, e cila në përmbajtjen e saj ka intervistën e dhënë prej subjektit në televizionin kombëtar {\*\*\*}.
  - Një kopje e faqes së web-it të televizionit {\*\*\*}, me titull: "Reforma në drejtësi, flet Luan Hasneziri".
  - Një kopje e shkrimit në faqen e portalit të njohur on-line "{\*\*\*}", me titull: "Kundërshtoi hetimin e pasurisë/Gjyqtari i Krimeve të Rënda në "ethe" nga Vettingu".
  - Një kopje e faqes së parë dhe të fundit të vendimit nr. 34, datë 10.4.2017, të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

<sup>6</sup> Këto akte janë administruar në Kolegj me nr. {\*\*\*} port., datë 19.07.2021, dhe janë përkatësisht:

- “Vërtetim pune”, i lëshuar nga Bashkia {\*\*\*}, Prefektura Selanik, datë 03.11.2019.
- Shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 16.07.2021, e KLGj-së.
- Shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 13.04.2021, e KLGj-së.
- Shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 23.04.2021, e KPK-së.

**12.1** Kolegji shqyrtoi fillimisht kërkesën e subjektit të rivlerësimit për marrjen e provave të bashkëlidhura ankimit dhe parashtrimeve, si dhe kërkesën për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike.

**12.2** Kolegji e shqyrtoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit për marrjen me cilësinë e provës të akteve që kanë shoqëruar ankimin e tij dhe e vlerësoi atë në raport me parashikimet ligjore që normojnë trajtimin e provës së re në gjykimin administrativ në shkallë të dytë, referuar nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, i cili parashikon: *Në ankim nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të kërkohej prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se pa fajin e tij nuk ka mundur t'i paraqesë këto fakte ose t'i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në gjykatën administrative të shkallës së parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj*, si edhe nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, në të cilin parashikohet se: *Kërkesa për marrjen e një prove refuzohet nga Komisioni ose Kolegji i Apelit, nëse nuk lejohet nga ligji ose në rastet kur: a) marrja e provës duket se është e panevojshme; b) fakti që kërkohet të provohet, është i parëndësishëm për vendimmarrjen ose mund të rezultojë i provuar gjatë gjyqësorit* – dhe konstatoi se provat e paraqitura nuk plotësonin kriteret e parashikuara nga dispozitat e cituara për të gëzuar statusin e provës që mund të merret në gjykimin në apel të çështjes. Subjekti nuk ka paraqitur ndonjë provë që provon se këto nuk janë paraqitur përgjatë hetimit administrativ pa fajin e tij dhe, për më tepër, nga analiza e tyre në raport me faktet që ai synon të provojë me to, Kolegji arriti në konkluzionin se ato janë të parëndësishme për zgjidhjen e çështjes, për pasojë vendosi të mos e pranojë këtë kërkesë të tij. Për sa u përket akteve të paraqitura me parashtrimet para seancës gjyqësore, Kolegji vlerëson se, në kuptim të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, subjekti i rivlerësimit nuk legjitimohet që këtij akti procedural t'i bashkëlidhë akte me pretendimin për marrjen e tyre si provë dhe se afati për të paraqitur prova të reja, shtrihet maksimalisht me paraqitjen e ankimit dhe nuk mund të zgjatet përtej këtij afati.

**12.3** Kolegji kryesisht, gjithashtu vlerësoi edhe nëse ekzistonin rrethana që e bënin të nevojshme kalimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, në kuptim të parashikimeve të nenit 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012 dhe konstatoi se nuk gjendej para asnjërës prej këtyre situatave që do ta çonin atë në vendimin për gjykimin e çështjes në seancë publike.

**12.4** Kolegji, në konkluzion të arsyetimit të mësipërm, vendosi të vijojë ta shqyrtojë çështjen në formën e gjyqësorit të zhvilluar në dhomë këshillimi, sipas parashikimit të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012.

## **B. Vlerësimi i Kolegjit për shkaqet e ankimit**

### **I. Shkaqe lidhur me pretendimet për cenim të parimeve të procesit të rregullt ligjor dhe aspektet procedurale të procesit të rivlerësimit**

#### **13. Analizimi i shkaqeve të ankimit për cenim të së drejtës për proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 6 të KEDNj-së:**

*Subjekti i rivlerësimit pretendon se fillimi i hetimit administrativ nga Komisioni, pa administruar raportet e organeve ndihmëse, i ka mohuar të drejtën për një mbrojtje efektive e për t'u njohur me të gjitha aktet që kanë të bëjnë me procesin e tij të rivlerësimit, që sipas subjektit përbën shkak të mjaftueshëm që ky vendim i Komisionit, në zbatim të shkronjës “a” të nenit 108 të Kodit të Procedurave Administrative, të konstatohet nga Kolegji si një akt absolutisht i pavlefshëm.*

**13.1** Lidhur me këtë pretendim, Kolegji konstaton se në ankim subjekti i rivlerësimit nuk analizon apo argumenton në kuptim të nenit 108 të Kodit të Procedurës Administrative, shkaqet që ai vlerëson se e bëjnë vendimin e Komisionit objekt shqyrtimi si absolutisht të pavlefshëm në referim të rasteve të pavlefshmërisë absolute sipas përcaktimit të nenit të mësipërm. Nga përmbajtja e ankimit, deduktohet se mungesa e raportit të vlerësimit nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”) lidhur

me kriterin e aftësive profesionale, në vlerësimin e subjektit, e bën vendimin objekt shqyrtimi si absolutisht të pavlefshëm.

**13.2** Në analizë të këtij pretendimi, Kolegji konstaton se në thelb subjekti pretendon se zhvillimi i procesit hetimor prej Komisionit vetëm për dy kritere, përkatësisht për kriterin e kontrollit të pasurisë dhe të figurës (duke mos administruar asnjë raport të strukturës përkatëse për kontrollin e aftësive profesionale), bën që vendimmarrja e Komisionit, e bazuar vetëm në konkluzionet për kontrollin e tyre, të jetë absolutisht e pavlefshme.

**13.3** Këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit, Kolegji e çmon si jo të drejtë e të bazuar, pasi vjen në kundërshtim si me përcaktimet e nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, ashtu edhe me qëndrimin tashmë të konsoliduar të mbajtur në jurisprudencën<sup>7</sup> e Kolegjit për këtë çështje. Kjo dispozitë ligjore përcakton qartazi se rivlerësimi është një proces i cili jo domosdoshmërisht fillon dhe finalizohet me shqyrtimin e 3 kritereve të procesit të rivlerësimit. Ky interpretim shihet në lidhje të ngushtë e në harmoni me përcaktimet e nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, i cili në pikën 1 parashikon se konfirmimi në detyrë i jepet subjektit të rivlerësimit në rast se plotësohen së bashku kushtet për arritjen e një niveli të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, kontrollit të figurës dhe nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale. Parashikimi i nenit 59, i cili parashikon se për konfirmimin në detyrë të një subjekti kërkohet domosdoshmërisht vlerësimi pozitiv për të 3 (tre) kriteret së bashku, duke u interpretuar *a contrario* lejon përfundimin e procesit të rivlerësimit edhe mbështetur vetëm në një ose dy kritere, për ato rastet kur për Komisionin rezulton se nga hetimet e kryera për këto kritere, subjekti nuk arrin një nivel të besueshëm, aq sa konfirmimi në detyrë nuk është më një opsion i vlefshëm.

**13.4** Në vijim të këtij arsytimi, Kolegji vlerëson se mbetet irelevant momenti i administrimit të raportit të KLGj-së, për sa kohë që nga hetimi administrativ dhe shkeljet e konstatuara në drejtim të kontrollit të kriterit të pasurisë, është arritur në përfundimin se subjekti nuk e kalon dot testin e besueshmërisë në këtë kriter. Administrimi ose jo në kohë i raportit të KLGj-së mbi aftësitë profesionale të subjektit, nuk duket se ka ndikuar vlerësimin që Komisioni ka kryer për kriteret e tjera dhe, në funksion të efikasitetit të procesit, në çfarëdolloj konkluzioni të kishte arritur, ai raport nuk do të arrinte të afektonte vlerësimin për kriteret e tjera të vlerësuara në mënyrë autonome e të konsideruara të mjaftueshme për arritjen e marrjes së një vendimi.

**14.** *Kolegji mori në shqyrtim pretendimet e subjektit për shkelje të rënda procedurale dhe materiale të Komisionit, për sa i përket procedurës së gjykimit, mënyrës së arsytimit e të analizës së fakteve dhe rrethanave të dala gjatë gjykimit, gjuhës së përdorur në arsytimin e vendimit dhe logjikës së gabuar në arritjen e përfundimeve, të cilat subjekti i konsideron se cenojnë rëndë të drejtën e tij për një proces të rregullt ligjor e vijnë në kundërshtim me Kushtetutën dhe me ligjin nr. 84/2016.*

**14.1** Lidhur me këtë shkak ankimi, Kolegji konstaton se pretendimet e subjektit në drejtim të procedurës së gjykimit, mënyrës së arsytimit, analizës së fakteve dhe procesit të rregullt ligjor kanë të bëjnë me faktin se Komisioni ka rrëzuar, pa i dhënë arsyet, pretendimit të subjektit për riçeljen e hetimit administrativ për vlerësimin e aftësive profesionale, duke e paragykuar, sipas subjektit, hapur çështjen dhe duke kryer shkelje të parimit të pavarësisë dhe të paanësisë.

**14.2** Për sa më sipër, Kolegji vëren se pretendimi i subjektit për mohim të së drejtës për t'u njohur me aktet dhe, për pasojë, për të ushtruar një mbrojtje efektive duket se lidhet kryesisht me kontrollin e aftësive profesionale, për të cilin pretendon se para fillimit të procesit të tij të rivlerësimit (hedhjes së shortit), Komisioni nuk kishte administruar raportin e KLGj-së, si dhe shpreh se edhe raporti i

---

<sup>7</sup> Vendimi nr. 1/2019 (JR), datë 31.01.2019; vendimi nr. 3/2013 (JR), datë 07.02.2019; vendimi nr. 8/2019 (JR), datë 16.04.2019; vendimi nr. 12/2018 (JR), datë 29.05.2019; vendimi nr. 15/2019 (JR), datë 17.07.2019; vendimi nr. 28/2019 (JR), datë 24.10.2019.



DSIK-së për kontrollin e figurës<sup>8</sup> është administruar me vonesë, pasi kishte nisur procesi i hetimit administrativ.

**14.3** Kolegji vëren se nëse këtë pretendim të subjektit e shikon në raport me shkaqet që kanë çuar Komisionin në vendimmarrjen për dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, konstatohet se: *Së pari*, referuar akteve të administruara në fashikull, është e vërtetë që Komisioni në momentin e fillimit të hetimit administrativ nuk ka pasur të administruar raportin e KLGj-së për kontrollin aftësive profesionale, i cili nuk gjendet i administruar në fashikullin e krijuar nga Komisioni. *Së dyti*, nga aktet e administruara në fashikull, rezulton se Komisioni nuk ka ndërmarrë asnjë hap hetimor në drejtim të kontrollit të aftësive profesionale, si dhe, për pasojë, nuk ka hartuar asnjë akt lidhur me të, për të cilin subjekti i rivlerësimit do të duhej të merrte dijeni.

**14.4** Në analizë të kësaj situatë faktike, nga të dhënat e fashikullit, rezulton se veprimtaria hetimore e kryer nga Komisioni është përqendruar në kontrollin e pasurisë, e cila i është bërë e njohur subjektit në momentin kur ai ka ushtruar të drejtën e tij për t'u njohur me dosjen. Nga aktet e administruara, rezulton se Komisioni nuk ka hetuar për kriterin e aftësive profesionale dhe as ka prodhuar ndonjë dokument/akt i cili të mos i jetë bërë i njohur subjektit, situatë e cila mund ta çonte atë drejt pretendimit se i është mohuar e drejta për t'u njohur me aktet.

Në këto kushte, kur një prej raporteve të organeve ndihmëse, sipas pretendimit të subjektit, është administruar me vonesë nga Komisioni, por, kur ai rezulton gjithashtu se nuk ka pasur ndikim në vendimmarrje, ky fakt e çon Kolegjin në përfundimin se i gjithë pretendimi i subjektit lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, në thelb nuk ka shkaktuar cenim të të drejtave të subjektit që lidhen me procesin e rregullt ligjor dhe as mohim të të drejtave për një mbrojtje efektive, pasi kriteri i vlerësimit të aftësive profesionale nuk është kryer aspak e, si i tillë, nuk është konsideruar si shkak shkarkimi dhe as ka shërbyer në ndonjë mënyrë për dhënien e masës disiplinore.

**14.5** *Në vijim të analizës së shkaqeve të ankimit lidhur me shkeljet procedurale të pretenduara se kanë ndodhur gjatë hetimit administrativ, Kolegji, pasi analizoi edhe pretendimin e subjektit që lidhet me rrëzimin e kërkesës paraprake të paraqitur prej tij në seancën dëgjimore të datës 24.05.2019, me anë të së cilës ai ka kërkuar përjashtimin e trupit gjykues të Komisionit, pasi ai ka paragjykuar procesin e tij të rivlerësimit, e gjen atë jo të drejtë dhe të bazuar në ligj për sa më poshtë.*

**14.6** Kolegji vëren se në ankim subjekti ka ngritur pretendimin se vendimi i Komisionit për rrëzimin e kërkesës së tij paraprake për përjashtimin e trupës gjyquese, është marrë në kundërshtim me ligjin, por nuk ka dhënë argumente dhe arsye konkrete pse ky vendim duhet të konsiderohet si i marrë në shkelje të ligjit. Në analizë të akteve të administruara në fashikull, konstatohet se vendimi për mospërjashtimin e trupës gjyquese të Komisionit, të përcaktuar me short për zhvillimin e procesit të rivlerësimit kalimtar të subjektit Luan Hasneziri, nuk është marrë nga e njëjta trupë, por nga një trupë tjetër gjyquese e Komisionit, e zgjedhur enkas për shqyrtimin e kërkesës për përjashtim. Gjithashtu, Kolegji vëren se as në Komision e as në ankim, subjekti nuk ka paraqitur asnjë të dhënë, provë apo argument lidhur me situatë/rrethana të cilat do të legjitimonin kërkesën e tij për përjashtimin e komisionerëve nga trupa gjyquese e Komisionit në kuptim të nenit 30 të Kodit të Procedurave Administrative e as dispozitave të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar. Në këto kushte, vendimi i Komisionit që ka rrëzuar këtë kërkesë konsiderohet si i marrë në vlerësim të drejtë të situatës faktike e ligjore që ka shoqëruar këtë vendimmarrje.

**14.7** *Lidhur me shkaqet e tjera të ankimit në drejtim të cenimit të parimeve të procesit të rregullt që kanë të bëjnë me pretendimet e subjekti të rivlerësimit, se: (i) procedura e hetimit administrativ*

---

<sup>8</sup> Për kontrollin e figurës, në ankim, subjekti nuk kundërshton vendimmarrjen e Komisionit, por vetëm shpjegon mënyrën e fillimit të hetimit dhe administrimin e tij.

*në Komisionit ka filluar, vazhduar dhe përfunduar nga të njëjtët anëtarë të trupit gjykues që kanë dhënë vendimin përfundimtar; (ii) vendimi i Komisionit për dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra ka cenuar parimin e paanësisë dhe të pavarësisë pasi nuk është marrë nga një gjykatë e caktuar me ligj, siç kërkon neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Karta Evropiane mbi Statusin e Gjyqtarëve.*

**14.8** Këto pretendime në ankimin e subjektit të rivlerësimit konstatohet se nuk lidhen në mënyrë specifike me çështje apo situata konkrete të rastit objekt shqyrtimi, por janë pretendime që lidhen në tërësi me zhvillimin e procesit të rivlerësimit nga Komisioni, të cilat, përveçse kanë gjetur trajtim të gjerë në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit, gjithashtu janë bërë objekt gjykimi e vlerësimi edhe i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj), e cila në vendimin e dhënë prej saj në çështjen *Altina Xhoxhaj k. Shqipërisë*, të datës 09.02.2021, ka mbajtur qëndrimin e saj për të gjitha çështjet e ngritura në ankim e të cituara më lart, duke i dhënë një zgjidhje përfundimtare analizës ligjore në nivel kushtetute e konvente të këtyre shkaqeve, qëndrime të cilat u japin përgjigje shteruese edhe pretendimeve të ngritura prej subjektit të rivlerësimit si më lart.

**14.9** Kështu, në vijim të këtij konstatimi, Kolegji sjell në vëmendje se pretendimi i subjektit se kjo çështje nuk është gjykuar nga një gjykatë e krijuar me ligj, pasi asnjë nga anëtarët e trupit gjykues të Komisionit nuk janë gjyqtarë dhe nuk kanë përvojë për gjykimin e çështjeve të tilla komplekse, ka gjetur përgjigje në vendimin GjEDNj-së *Altina Xhoxhaj k. Shqipërisë* të datës 09.02.2021, tek i cili është arsyetuar se: [...] *Gjykata arrin në përfundimin se, duke pasur parasysh faktin se si KPK ashtu dhe KPA ishin krijuar dhe formuar në një mënyrë legjitime duke përmbyshur kërkesat e një “gjykate të krijuar me ligj”, kërkesja i ishte adresuar “Gjykatës”, sipas kuptimit të kushtit të parë të testit Vilho Eskelinen. Për këtë arsye, neni 6/1 i Konventës gjen zbatim nën aspektin civil të saj” [...]* “Gjykata më tej përsërit se një organ i cili nuk është klasifikuar si një nga gjykatat e vendit, për qëllimet e Nenit 6/1, mund të klasifikohet brenda konceptit të një “gjykate” në kuptimin material të kësaj shprehjeje. Sipas praktikës gjyqësore të vendosur të Gjykatës, një “gjykatë” karakterizohet në atë kuptim thelbësor të termit nga funksioni i saj gjyqësor, që do të thotë, të vendosë për çështjet brenda kompetencës së saj në bazë të rregullimeve ligjore dhe pas procedurave të zhvilluara në një mënyrë të përcaktuar. Ajo gjithashtu duhet të përmbyshë një sërë kushtesh të mëtejshme, “të tilla si pavarësia, në veçanti nga pushteti ekzekutiv, paanësia, kohëzgjatja e mandatit të anëtarëve të saj [...]” (shih *Guðmundur Andri Ástráðsson*, cituar më lart, paragrafi 219, dhe referenca cituar aty). *Fuqia e vendimit buron nga vetë nocioni i “gjykatës” (shih Mutu dhe Pechstein k. Zvicrës, nr. 40575/10 dhe 67474/10, paragrafi 139, 2 tetor 2018, dhe referencat e cituara në të).*

**14.10** Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se kalimi i barrës së provës prej Komisionit është bërë në kundërshtim të hapur me përcaktimet e nenit D, pikat 4 e 5 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe me nenin 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, pasi subjekti shpreh se ka përmbyshur detyrimin për dorëzimin e deklaratës vetting e se nuk u provua se ka më shumë se 2-fishi i pasurisë së ligjshme e as u provua se është përpjekur të fshehë e paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, Kolegji shpreh se:

**14.11** Në drejtim të pretendimeve të subjektit që lidhen me vlerësim të gabuar të situatës faktike prej Komisionit, Kolegji mori në shqyrtim pretendimin e tij se kalimi i barrës së provës është bërë në kundërshtim të hapur me përcaktimet e nenit D, pikat 4 e 5 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe me nenin 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, pasi ai ka dorëzuar deklaratën vetting e se është provuar se nuk ka më shumë se 2-fishi i pasurisë së ligjshme e as është përpjekur të fshehë e paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi.

**14.12** Lidhur me këto pretendime të subjektit të rivlerësimit, Kolegji vëren se vendimi nr.170, datë 26.06.2019, objekt shqyrtimi është marrë bazuar në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 pasi, nga analiza ekonomike e kryer, ka rezultuar se subjekti nuk ka pasur burime të ligjshme financiare për të

mbuluar kostot e jetesës dhe për të krijuar pasuritë e deklaruara (*apartament dhe kursime në cash*). Në këtë vendim të Komisionit konstatohet se në asnjë pjesë të tij nuk arsyetohet lidhur me 2-fishin e pasurisë së ligjshme.

**14.13** Për këtë shkak ankimi, Kolegji arsyeton se në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, si dhe referuar jurisprudencës së gjerë të Kolegjit lidhur me këtë çështje, është e panevojshme dhe irelevante analiza e parashikimit të nenit 61, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 për sa kohë që vendimi i Komisionit nuk është marrë bazuar mbi këtë dispozitë. Në rastin objekt shqyrtimi, konstatohet se nga analiza e kryer si në Komision, ashtu edhe në Kolegji, subjekti ka rezultuar me situatë financiare negative, (-) 4.677.081 lekë në vitin 2006, në kohën e blerjes së apartamentit me sip. 135 m<sup>2</sup>, ndodhur në rr. “{\*\*\*}”, Tiranë. Nga të dhënat e administruara përgjatë hetimit administrativ në drejtim të verifikimeve të burimit të krijimit të kësaj prone, Komisioni ka konkluduar se subjekti nuk ka mundur të provojë se kjo pronë është financuar me të ardhura të ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.

**14.14** Në të njëjtën linjë arsyetimi, Kolegji vëren se masa disiplinore nuk është dhënë pasi është konstatuar se subjekti nuk ka dorëzuar deklaratën e pasurisë sipas shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016, të njohur ndryshe si deklarata “vetting”, e as se nga hetimi administrativ u provua se subjekti ka pasur më shumë se 2-fishi i pasurisë së ligjshme, por për shkak se subjekti ka dështuar të provojë ligjshmërinë e të ardhurave të përdorura për blerjen e apartamentit të tij në Tiranë në momentin e pagesës së saj. Në këto kushte, Kolegji, këto pretendime të subjektit të rivlerësimit, i gjen të paargumentuara e të pabazuara ligjërisht, për sa kohë që asnjë prej shkaqeve të ngritura në to nuk ka shërbyer si bazë për marrjen e vendimit objekt shqyrtimi.

**14.15** Kolegji shqyrtoi gjithashtu edhe *pretendimin se Komisioni nuk ka vlerësuar, analizuar dhe shpjeguar/arsyetuar në vendim aktet e paraqitura në cilësinë e provës nga subjekti përgjatë hetimit, si dhe përgjatë seancës dëgjimore, për të cilën analizon sa vijon.*

**14.16** Pretendimet e subjektit të rivlerësimit se Komisioni nuk ka vlerësuar, analizuar dhe shpjeguar/arsyetuar në vendim aktet e paraqitura prej tij në cilësinë e provës përgjatë hetimit, pas analizimit të tyre, Kolegji i vlerëson se janë të pabazuara në fakte e në ligj pasi, referuar përmbajtjes së vendimit të Komisionit objekt shqyrtimi, vërehet se në tërësinë e tij ky vendim përmban analizë të akteve të paraqitura nga subjekti përgjatë hetimit administrativ<sup>9</sup>, të cilat janë përmendur dhe analizuar edhe në vendim. Kjo e dhënë për Kolegjin dëshmon se Komisioni ia ka nënshtruar vlerësimit të tij provat e sjella nga subjekti. Fakti se këto akte e prova të subjektit, Komisioni nuk i ka vlerësuar në mënyrën e dëshiruar prej tij, nuk do të thotë se ka munguar vlerësimi lidhur me to, në kuptim të garantimit të elementeve të procesit të rregullt ligjor.

**14.17** Për sa arsyetuar më sipër, Kolegji, pretendimet e subjektit për shkelje të rënda procedurale dhe për shkelje të parimeve të procesit të rregullt ligjor gjatë gjykimit në Komision, i konsideron të paargumentuara dhe të pabazuara ligjërisht.

## **II. Shkaqe që lidhen me kriterin e kontrollit të e pasurisë**

15. *Subjekti pretendon se Komisioni ka kryer shkelje ligjore lidhur me vlerësimin e gabuar të gjendjes faktike në lidhje me pasurinë e paluajtshme banesë, të ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, me sip. 135 m<sup>2</sup> që lidhen me :* (i) *Moskonsiderimin e kontratës së shitblerjes së kësaj prone si të lidhur në rrethana të veçanta, pasi të dy palët njiheshin dhe kishin besim te njëri-tjetri, të cilët kishin një marrëdhënie të posaçme për të cilën duhet të gjente aplikim neni 232, shkronja “ç” e Kodit Civil.* (ii) *Pranimi si alternativë e vetme për pagimin totalisht të çmimit të kësaj pasurie të paluajtshme të*

<sup>9</sup> Shih paragrafët e vendimit të Komisionit nr. 170, datë 26.06.2019: nr. 26 /dh; 32.2.3; 32.2.9; 32.3.7.

versionit që në mënyrë formale parashikon kontrata e shitblerjes “se çmimi është paguar para lidhjes së kontratës jashtë zyrës noteriale”, ka çuar Komisionin në përfundim të gabuar, pasi ky është një fakt i pavërtetë. (iii) Qëndrimi i Komisionit se, nëse pranojmë alternativën e paraqitur nga subjekti për pagimin e kësaj prone, sërish ai rezulton me situatë financiare negative, me (-) 386 638 lekë, bazuar në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit, nuk duhet të shërbejë si shkak shkarkimi. (iv) Përlllogaritja e shpenzimeve të jetesës nga Komisioni në vitin 2006, është e gabuar pasi bazohet në të dhëna jo të sakta.

**15.1** Nga hetimi administrativ, ka rezultuar se lidhur me shitblerjen e apartamentit me sip. 135 m<sup>2</sup> me vendndodhje në Tiranë, situata faktike paraqitet si vijon.

Në bazë të kontratës së shitblerjes nr. {\*\*\*}, datë 12.12.2006, mes shitëse A. P. dhe S. H. (përfaqësuar me prokurën nr. {\*\*\*} kol., datë 11.12.2006, nga z. A. F.<sup>10</sup>) dhe blerësit Luan Hasani<sup>11</sup>, është realizuar kalimi i pronësisë të subjekti i rivlerësimit mbi apartamentin me sip. 135 m<sup>2</sup>, në vlerën 5.900.000 lekë. Në këtë kontratë shitblerjeje, referuar çmimit të shitjes prej 5.900.000 lekësh, palët kanë deklaruar që ajo është paguar nga blerësi jashtë zyrës noteriale dhe se shitësi nuk ka pretendime për të.

**15.2** Lidhur me faktin e përshkruar më lart, subjekti pretendon se kontrata e shitblerjes së apartamentit me sip. 135 m<sup>2</sup> në Tiranë, e lidhur midis tij dhe përfaqësuesit të palës shitëse, z. A. F., për shkak të njohjes dhe marrëdhënies së besimit midis palëve, është lidhur në kushte të veçanta. Subjekti pretendon se për këtë arsye, referuar kësaj kontrate shitblerjeje, nuk gjen zbatim rregullimi ligjor i parashikuar në nenin 232 të Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit nuk lejohet prova me dëshmitarë kundër ose tej përmbajtjes së një akti zyrtar apo privat që përbën provë të plotë. Në këtë rast, për shkak të rrethanave të veçanta dhe të marrëdhënieve të posaçme të palëve, lejohet prova me dëshmitarë, duke u zbatuar germa “ç” e nenit 233 të këtij kodi që përcakton se lejohet të provohen fakte të caktuara me dëshmitarë, nëse ekzistojnë rrethana ose marrëdhënie të posaçme ndërmjet palëve.

**15.3** Në analizë të akteve të administruara në fashikullin e krijuar përgjatë hetimit administrativ, Kolegji konstaton se në mbështetje të këtij qëndrimi, subjekti ka paraqitur si provë në Komision një deklaratë noteriale të përfaqësuesit të shitësit, z. A. F.<sup>12</sup> (e cituar edhe në paragrafin 32.2.3 të vendimit të Komisionit), tek e cila ai deklaron se dinamika e pagesës së çmimit të apartamentit ka qenë e njëjtë me atë të shpjeguar përgjatë procesit të rivlerësimit nga subjekti dhe jo sipas përcaktimit të kontratës së shitblerjes të apartamentit, e cila pasqyron se në datën e lidhjes së saj, 12.12.2006, çmimi i përcaktuar për shitjen e kësaj prone ka qenë i paguar jashtë zyrës noteriale.

**15.4** Kolegji, lidhur me këtë situatë të prezantuar nga subjekti i rivlerësimit mbi modalitetet e pagesës së apartamentit me sip. 135 m<sup>2</sup> në Tiranë, konstaton:

*Së pari*, se qëndrimet e shpjegimet e subjektit vijnë në kundërshtim me të dhënat e kontratës noteriale të shitblerjes së kësaj prone, e cila përcakton të kundërtën e asaj që deklaron subjekti, pra që çmimi i shitjes së kësaj prone i është paguar palës shitëse nga subjekti i rivlerësimit para lidhjes së kontratës, pra para datës 12.12.2006.

<sup>10</sup> I cili në kohën e lidhjes së kësaj kontrate shitblerjeje ushtronte funksionin e gjyqtarit.

<sup>11</sup> Subjekti i rivlerësimit, më 17.01.2007, ka ndryshuar mbiemër nga “Hasani” në “Hasneziri”.

<sup>12</sup> Në vendimin e Komisionit objekt shqyrtimi, citohet deklarimi i ish-subjektit A. F. në procesin e tij të rivlerësimit, i cili ka shprehur: [paragrafi 32.2.4] “Të nesërmen e largimit të tyre, shtetasi Luan Hasani më ka kontaktuar mua duke më bërë të ditur se kishite siguruar paratë për blerjen e banesës dhe menjëherë pas kësaj, ndërsa isha i pajisur me prokurë nga pronarët e apartamentit A. P. dhe S. H., unë kam lidhur në emër dhe për llogari të tyre kontratën e shitjes nr. {\*\*\*}, datë 12.12.2006. Çmimi i shitjes së banesës prej 5.900.000 lekësh është paguar cash nga ana e blerësit Luan Hasani. Nga kjo shumë, me marrëveshje me kunatin tim A. P., unë kam mbajtur si hua një pjesë të saj, që e konvertuar ka qenë 10.000 euro, kurse pjesën tjetër të çmimit të paguar nga blerësi unë ia kam dorëzuar babait të kunatit tim, njëherazi dhe vjehrrin im, shtetasi P. P.”.

*Së dyti*, lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se kjo kontratë, për shkak të njohjes së palëve, duhet konsideruar si kontratë e lidhur midis palëve në një marrëdhënie të posaçme, dhe në të tilla kushte duhet të gjejë zbatim neni 233, germa “c” e K.Pr.Civile, i cili përcakton se një nga rastet e lejimit të marrjes së provës me dëshmitarë është ai kur [...] ç) për shkak të rrethanave në të cilat është kryer veprimi juridik ose të marrëdhënieve të posaçme të palëve, nuk ka qenë e mundur të merrej prova me shkresë, Kolegji e konsideron të drejtë qëndrimin e Komisionit për moskonsiderimin e kësaj kontrate si të lidhur midis palëve që janë në marrëdhënie të posaçme midis tyre pasi:

(i) Neni 233, germa “ç” e K.Pr.Civile parashikon se në kushtet kur ndodhemi para bashkekzistencës së dy elementeve, të një marrëdhënieje të posaçme dhe të mungesës së aktit të shkruar, për të provuar faktin në konflikt, lejohet prova me dëshmitarë. (ii) Në rastin konkret, *së pari* jemi para një situatë krejtësisht të ndryshme, pasi ndërmjet palëve kemi një akt të shkruar, një kontratë shitblerjeje të lidhur para noterit, dhe *së dyti* palët nuk provojnë që kanë një marrëdhënie të tillë, e cila duhet të konsiderohet si e posaçme në kuptim të parashikimeve të dispozitës së mësipërme, pasi përveç lidhjes profesionale e shoqërore për shkak të saj, nuk pretendohet se mes tyre ekziston ndonjë lidhje që shkon përtej kësaj natyre. Në këto rrethana, Kolegji vlerëson se me të drejtë Komisioni nuk e ka kualifikuar këtë marrëdhënie si të posaçme në kuptimin që legjislacioni ka dhe që subjekti kërkon të përdorë.

15.5 Në vijim të këtij arsytimi, Kolegji çmon se ky pretendim i subjektit, përveçse është jashtë sferës së rasteve që rregullon neni 233 i Kodit të Procedurës Civile, ai dukshëm është një përpjekje e tij për të rregulluar apo ndryshuar me dëshmi përcaktime të kontratës tashmë të zbatuar ndërmjet palëve dhe të pakontestuar asnjëherë prej tyre përpara këtij procesi rivlerësimi.

Për këto arsye, Kolegji, këtë pretendim të subjektit, e konsideron të padrejtë e të pabazuar ligjërisht.

15.6 Bazuar në konkluzionet e mësipërme, Kolegji, ashtu si edhe Komisioni, vlerëson se në kuptim të analizës financiare të kryer për subjektin e rivlerësimit, ajo duhet të bëhet duke konsideruar përcaktimet e kontratës noteriale të shitblerjes së apartamentit në Tiranë, lidhur me modalitetet e pagesës së çmimit të shitjes, në funksion të kontrollit të aftësisë financiare të subjektit për të përballuar me burime të ligjshme blerjen e kësaj pasurie, në momentin e kryerjes së kësaj pagese, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Në logjikë të arsytimit të mësipërm, Kolegji konstaton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në mënyrë të pasaktë burimet për krijimin e kësaj pasurie në deklaratën *vetting*, duke përcaktuar si të tilla burime të cilat nuk ekzistonin në kohën e pagimit të çmimit të shitjes sipas përcaktimit kontraktor, deklarime të cilat vlerësohen si në kundërshtim me detyrimin për deklarime të sakta sipas nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

15.7 *Lidhur me analizën financiare të kryer në Komision, Kolegji mori në shqyrtim pretendimin e subjektit të rivlerësimit se kjo analizë ka pasaktësi pasi përlllogaritja e shpenzimeve të jetesës nga Komisioni në vitin 2006, është e gabuar pasi bazohet në të dhëna jo të sakta. Nga shqyrtimi i këtij pretendimi, Kolegjit i rezultoi se:*

15.8 Për analizën financiare të vitit 2006, subjekti pretendon se konkluzionet e Komisionit se ai ka një diferencë negative prej (-) 4.786.638 lekësh, janë të gabuara, pasi jo e gjithë shuma prej 5.900.000 lekësh është paguar deri më datë 12.12.2006. Sipas pretendimeve të subjektit, nuk është e vërtetë kryerja e shpenzimeve për blerjen e apartamentit në masën 5.900 000 lekë në vitin 2006, pasi ai në këtë vit ka shpenzuar vetëm 1.500.000 lekë, dhe se pjesa e mbetur prej 4.400.000 lekësh është paguar pas marrjes së huas prej vëllait A. H. Sipas këtij pretendimi, analiza financiare për vitin 2006 del me një balancë pozitive prej (+) 272.919 lekësh. Subjekti gjithashtu, me ankimin, pretendon se edhe sikur viti 2006 të rezultonte me diferencë negative prej (-) 386.638 lekësh, siç ka konkluduar Komisioni, në zbatim të parimit të proporcionalitetit, kjo është një vlerë e papërfillshme dhe, si e tillë, nuk mund të vlerësohet si një pamundësi për të justifikuar krijimin e kësaj pasurie.

15.9 Në analizë të këtij pretendimi të subjektit të rivlerësimit lidhur me mënyrën e pagesës së apartamentit në Tiranë, Kolegji së pari konstaton se në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit, si

burime të financimit për blerjen e apartamentit prej 135 m<sup>2</sup> në Tiranë, ka deklaruar se kanë shërbyer: (i) të ardhurat nga kontrata e huas nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 04.01.2007, lidhur midis subjektit dhe vëllait të tij A. H.; (ii) të ardhurat nga kontrata e kredisë me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 09.01.2007. Për këtë pasuri rezulton se subjekti ka deklaruar gjithashtu edhe më parë në deklaratën periodike vjetore të vitit 2006 po të njëjtat burime financimi të saj.

**15.10** Në drejtim të burimeve të financimit të kësaj pasurie dhe modaliteteve të pagesës së çmimit të apartamentit prej 135 m<sup>2</sup>, në Tiranë, nga aktet e administruara në fashikull, Kolegji, ashtu si edhe Komisioni, ka konstatuar se në kontratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., e nr. {\*\*\*} kol., datë 12.12.2006, të shitblerjes të apartamentit prej 135 m<sup>2</sup>, në Tiranë, të lidhur midis palës shitëse, z. A. P. dhe znj. S. H. (përfaqësuar me prokurë nr. {\*\*\*} kol., datë 11.12.2006, z. A. F.) dhe blerësit Luan Hasani, palët, referuar kalimit të shumës prej 5.900.000 lekësh që përbën çmimin e shitjes së kësaj prone, kanë deklaruar që ajo është paguar nga blerësi jashtë zyrës noteriale dhe shitësi nuk ka pretendime për të.

**15.11** Për shkak të faktit se përfaqësuesi i palës shitëse të apartamentit prej 135 m<sup>2</sup> në Tiranë ka qenë një ish-subjekt rivlerësimi<sup>13</sup>, Kolegji, si edhe Komisioni, ka marrë në konsideratë edhe deklaratimet e këtij të fundit lidhur me modalitetet e pagesës së kësaj prone, të cilat ai i ka bërë përgjatë procesit të tij të rivlerësimit, duke deklaruar se: *Të nesërmen e largimit të tyre, shtetasi Luan Hasani më ka kontaktuar mua duke më bërë të ditur se kishte siguruar paratë për blerjen e banesës dhe menjëherë pas kësaj, ndërsa isha i pajisur me prokurë nga pronarët e apartamentit, A. P. dhe S. H., unë kam lidhur në emër dhe për llogari të tyre kontratën e shitjes nr. {\*\*\*}, datë 12.12.2006. Çmimi i shitjes së banesës, prej 5.900.000 lekësh, është paguar cash nga ana e blerësit Luan Hasani. Nga kjo shumë, me marrëveshje me kunatin tim A. P., unë kam mbajtur si hua një pjesë të saj, që e konvertuar ka qenë 10.000 euro, kurse pjesën tjetër të çmimit të paguar nga blerësi unë ia kam dorëzuar babait të kunatit tim, njëherazi dhe vjehrrin im, shtetasi P. P.*

**15.12** Për sa më sipër, ky element u shton besueshmëri deklaratimeve të palëve të pasqyruara në kontratën e shitblerjes, për sa i përket momentit dhe modalitetit të pagimit të çmimit të blerjes, duke mbështetur e konfirmuar këto deklaratime nga personi që për shkak të rolit të tij përfaqësues në kontratë, është ai i cili ka pasur dijeni të drejtpërdrejtë mbi ato që janë deklaruar para noterit. Në këtë kuptim, deklaratimet e përfaqësuesit, z. A. F., shkojnë në të njëjtën linjë me faktet që provon kontrata noteriale e shitblerjes, e cila është një akt zyrtar me fuqi të plotë provuese sipas parashikimit të nenit 253 të Kodit të Procedurës Civile. Deklarimet e ndryshme të dhëna nga z. A. F., në një kontekst tjetër dhe të mëvonshëm e që natyrshëm lexohen në favor të subjektit të rivlerësimit, konsiderohen si të pabesueshme prej Kolegjit, pasi ato nuk mbështeten nga ndonjë e dhënë që buron nga ndonjë provë tjetër. Në këto kushte, Kolegji e gjen të drejtë qëndrimin e mbajtur nga Komisioni se analiza financiare për vitin 2006 duhet të kryhet duke konsideruar të paguar të gjithë çmimin e blerjes prej 5.900.000 lekësh, para datës së lidhjes së kontratës, 12.12.2006, duke e konsideruar këtë version si të vetmin të bazuar në prova.

**15.13** Pavarësisht sa më lart, me qëllimin për të qenë garantist dhe shterues në drejtim të shqyrtimit të pretendimeve të subjektit, Kolegji, lidhur me burimet e financimit të përdorur për blerjen e apartamentit, analizoi edhe versionin tjetër të paraqitur prej tij në Komision, mbështetur në deklaratimet e deklaratës *vetting* dhe asaj periodike se çmimi është financuar prej huas nga vëllai dhe më pas kredisë bankare, si edhe versionin tjetër të paraqitur prej tij, sipas të cilit subjekti pretendon se në vitin 2006 është paguar vetëm shuma prej 1.500.000 lekësh dhe pjesa tjetër është likuiduar në momentin e marrjes së kredisë e cila ka shkuar për shlyerjen e huas së vëllait.

---

<sup>13</sup> Z. A. F.

**15.14** Në analizë të këtyre pretendimeve të subjektit, Kolegji kreu analizën financiare për vitin 2006 duke ndjekur të dy këta skenarë të likuidimit të çmimit të apartamentit, sipas të cilëve subjekti përdor në këtë vit vetëm fondet e tij personale për pagimin e çmimit dhe nga kjo analizë rezultoi se:

- Në rastin kur analiza ekonomike kryhet duke konsideruar përcaktimet e kontratës së shitjes për likuidimin e të gjithë çmimit të blerjes së apartamentit në vitin 2006, subjekti i rivlerësimit rezulton me mungesë të burimeve të ligjshme për blerjen e kësaj prone, në vlerën (-) 4.677.081 lekë.
- Në rastin kur konsiderojmë se likuidimi i çmimit të apartamentit në vitin 2006 ka qenë pjesor, në masën 1.500.000 lekë, subjekti rezulton me mungesë të burimeve të ligjshme në masën (-) 277.081 lekë<sup>14</sup>.

**15.15** Në përfundim, pretendimin e subjektit të rivlerësimit lidhur me modalitetet e pagesës së çmimit të apartamentit me sip. 135 m<sup>2</sup>, ndodhur në Tiranë, sipas të cilit në vitin 2006 është kryer vetëm pagesë e pjesëshme e tij në masën 1.500.000 lekë, Kolegji e gjen të pabazuar në prova, pasi vetë kontrata noteriale e shitblerjes së kësaj prone ka të përcaktuar saktësisht se çmimi i blerjes ishte likuiduar në momentin e lidhjes së kontratës, 12.12.2006.

**15.16** Në drejtim të pretendimit të subjektit lidhur me kohën e pagesës së çmimit të blerjes së apartamentit me sip. 135 m<sup>2</sup> në Tiranë, Kolegji, ashtu si edhe Komisioni, ka kryer analizën financiare edhe duke konsideruar shpjegimet e subjektit se kjo pasuri është paguar me të ardhurat nga huaja e vëllait të subjektit e më pas nga kredia bankare. Kolegji e vlerësoi të drejtë përpjekjen e Komisionit për të qenë garantist dhe për të analizuar çështjen edhe në drejtim të verifikimit të burimeve sipas asaj që vetë subjekti ka deklaruar, pavarësisht se, në analizë të akteve të administruara nga hetimi e të përmendura më lart, duket se versioni i deklaruar në deklaratën *vetting* nuk është i saktë/vërtetë apo qoftë edhe vetëm nuk arriti të provohet prej subjektit.

**16.** *Në vijim të sa më sipër, Kolegji analizoi pretendimin e tij se konkluzioni i Komisionit lidhur me të ardhurat e ligjshme të vëllait të tij është i pasaktë, pasi:*

*(i) Me provat e paraqitura ka mundur të provojë burimin e ligjshëm të të ardhurave të vëllait, A. H., të cilat ia ka dhënë hua subjektit në vitin 2007, duke pretenduar gjithashtu se konkluzioni i Komisionit është i padrejtë, pasi aktet e paraqitura nga subjekti, në cilësinë e provës, përbëjnë indicie të plota që provojnë faktin se personi tjetër i lidhur (vëllai), këto të ardhura i ka krijuar nga puna e tij si emigrant në Greqi.*

*(ii) Referuar përcaktimeve ligjore, subjekti pretendon se ligjshmëria e pasurisë lidhet me burimin e krijimit të saj dhe jo me pagesën e tatimit mbi këto të ardhura.*

**16.1** Në funksion të dhënies përgjigje dhe shqyrtimit të këtij pretendimi të subjektit, duke konsideruar alternativën e deklaruar prej subjektit për mënyrën e kohën e pagimit të çmimit të blerjes së pasurisë, Kolegji çmon se me të drejtë Komisioni e ka konsideruar vëllain e subjektit si person tjetër të lidhur në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, për të cilin subjekti ka detyrimin për të provuar ligjshmërinë e të ardhurave që ai i ka dhënë hua. Në këto kushte, me të drejtë, është marrë në analizë dokumentacioni i dorëzuar nga subjekti përgjatë hetimit, lidhur me të ardhurat e siguruara nga vëllai i tij nga emigrimi në Greqi, të cilat kanë shërbyer si burim për të mundësuar huan e dhënë në kuptim të nenit D, pika 3 e Kushtetutës, e të nenit 32, pika 4 dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016.

---

<sup>14</sup> Në analizën e kryer në Kolegji sipas versionit të dytë, tek i cili pranohet pretendimi i subjektit se likuidimi i çmimit të apartamentit në vitin 2006 ka qenë pjesor, në masën 1 500 000 lekë, analiza financiare është bërë duke konsideruar shpenzimet e kostove të jetesës vetëm për subjektin e rivlerësimit, meqenëse ai figuron i martuar në vitin 2007. Gjithashtu, në këtë analizë janë përfshirë kursimet në cash sipas deklarimeve të bëra për shtesat dhe pakësimet prej subjektit në deklaratat periodike. Edhe në këtë version, analiza ekonomike e subjektit të rivlerësimit për vitin 2006, nuk mbulon me të ardhura të ligjshme as pagimin e pjesëshëm, të pretenduar të paguar prej tij në këtë vit.

**16.2** Në drejtim të ligjshmërisë së të ardhurave të krijuara nga personi tjetër i lidhur, në masën 5.900.000 lekë, subjekti ka paraqitur pranë Komisionit disa akte me të cilat ai ka synuar të provojë se këto janë të ardhura të krijuara nga puna e vëllait si emigrant në Greqi.

**16.3** Nga hetimi administrativ i kryer, nga korrespondenca me ALUIZNIN, Komisioni ka konstatuar se A. H. është poseduesi i një objekti me 3 (tre) kate, me sip. 110 m<sup>2</sup>/kat, ndërtim pa leje, i deklaruar në formularin e vetëdeklarimit për legalizim “{\*\*\*}” nr. {\*\*\*} prot., datë 02.08.2006, i ndërtuar në vitin 1998 në lagjen “{\*\*\*}” në Mamurras. Gjithashtu vëllai i subjektit, A. H., rezulton të jetë aplikues në procesin e legalizimit edhe të një objekti tjetër, pasi me deklaratën për përfshirjen në procedurat e legalizimit të ndërtimit pa leje dhe/ose shtesës në ndërtim me leje, me aplikimin me nr. {\*\*\*} prot., datë 22.12.2014, ka deklaruar një ndërtim të realizuar në vitin 2002. Nga ana e Komisionit, në rezultatet paraprake të hetimit, është bërë një përlllogaritje e vlerës së ndërtimit të kësaj banese<sup>15</sup> me 3 kate, e deklaruar si ndërtim pa leje në emër të vëllait të subjektit A. H. Nga dokumentacioni i administruar përgjatë hetimit administrativ, rezulton se ky shtetas nuk ka pasur kursime apo shuma të qarkulluara nëpërmjet sistemit bankar, për pasojë Komisioni ka konsideruar edhe këtë rrethanë në drejtim të mundësive të vëllait të subjektit për të dhënë hua shumën e deklaruar prej tij.

**16.4** Në ankim, lidhur me të ardhurën e siguruar nga vëllai i tij si emigrant në Greqi, subjekti pretendon se është një e vërtetë e pamohueshme që vëllai i tij, A. H., ka punuar në Greqi dhe ka kursyer para nga puna e tij si emigrant, nga viti 1995 deri në vitin 2006, të paktën në vlerën 5,9 milionë lekë, por për shkaqe objektive e ka të pamundur të paraqesë dokumentacionin nga organet fiskale greke që të provojë të ardhurat neto dhe mënyrën e kryerjes së pagesave mujore.

Subjekti deklaron se nga viti 1995 deri në vitin 2001, vëllai A. H. ka punuar si emigrant i papajisur me leje qëndrimi, por ka kursyer para, ndërsa për periudhën 2001-2006, fakti që ai ka punuar në një shtet të huaj dhe koha e largët kur ai ka punuar, e bën të pamundur paraqitjen e dokumentacionit të plotë. Për periudhën 2004-2006, përveç deklaratave të dy punëdhënësve grekë, subjekti ka paraqitur edhe fotokopjen e pasaportës së vëllait, ku vërtetohen hyrje-daljet e tij nga Greqia, si dhe tri dokumente të tjera që provojnë qëndrimin dhe punësimin e tij të rregullt në Greqi, në këtë periudhë. Subjekti pretendon se gjendet në kushtet e pamundësisë objektive për të disponuar dokumentacion justifikues referuar ligjshmërisë së krijimit të pasurive të vëllait të tij, pasi gjendet në kushtet e pamundësisë për marrjen e këtij informacioni.

**16.5** Në analizë të këtij qëndrimi të subjektit të rivlerësimit lidhur me të ardhurat e siguruara nga vëllai i tij në emigracion në Greqi, Kolegji kreu analizën ekonomike duke përmbledhur të dhënat financiare që përmbajnë këto deklarata të lëshuara nga punëdhënësit grekë për të gjithë periudhën e pretenduar nga subjekti, nga viti 1995 deri në vitin 2006. Në analizë të akteve të përcjella Komisionit nga vetë subjekti i rivlerësimit lidhur me të ardhurat e punësimit të vëllait në Greqi, konstatohet se një pjesë e tyre janë deklarime të individëve të ndryshëm, shtetas grekë, që deklarojnë se kanë punësuar vëllain e subjektit përgjatë kohës kur ai nuk ka pasur leje qëndrimi, ndërsa një pjesë tjetër e akteve janë dokumente të lëshuara nga organet shtetërore.

Kolegji, në zbatim të përcaktimeve të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës e të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, vlerësoi të përfshijë në analizën financiare ato të ardhura për të cilat rezulton se personi tjetër i lidhur ka pasur një marrëdhënie të rregullt punësimi të deklaruar në organet kompetente të Greqisë dhe përgjatë së cilës ai figuron i pajisur me leje qëndrimi.

---

<sup>15</sup> Komisioni, në Rezultatet Paraprake të Hetimit, ka shprehur se: “[...] Në mungesë të të dhënave konkrete mbi vlerën e shpenzuar për këtë ndërtim dhe në referim të duket se për këtë banesë ai duhet të ketë shpenzuar mes: vlerës 6.930.000 lekë (në vitin 1998) dhe 6.938.100 lekë (në vitin 2002).



Nga aktet e përcjella në Komision nga subjekti”, rezulton se periudha e punësimit të vëllait të subjektit në Greqi, e cila sipas dokumentacionit të administruar figuron e provuar me dokumentacion të rregullt si leje pune e leje qëndrimi, është për periudhën 14.09.2001 deri më 15.03.2002 dhe nga 15.03.2003 deri më 15.03.2004, periudhë gjatë së cilës rezulton se maksimumi i të ardhurave të realizuara prej tij është rreth 1.468.000 lekë. Kolegji konstaton se kjo shifër është ndjeshëm më e vogël në krahasim me shifrën e pretenduar nga subjekti si e ardhur e ligjshme nga puna e vëllait në Greqi, prej 5.900.000 lekësh, pa konsideruar në këtë konstatim, vlerat e mundshme të shpenzuara prej vëllait të subjektit për ndërtimin e objektit të përmendur më lart.

**16.6** Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se ligjshmëria e pasurisë lidhet me burimin e krijimit të saj dhe jo me pagesën e tatimit mbi këto të ardhura, siç edhe është arsyetuar më sipër në këtë vendim, subjekti, lidhur me të ardhurat që ai deklaron se janë siguruar nga punësimi i vëllait të tij në Greqi, nuk ka mundur që për pjesën më të madhe të tyre të provojë si burimin e ligjshëm, pra faktin që ato rrjedhin nga marrëdhënia e punës, pasi nuk ka mundur të provojë as qëndrimin e ligjshëm si emigrant të vëllait, si dhe as shlyerjen e detyrimeve tatimore. Të ardhurat e siguruar nga puna e vëllait të subjektit [14.09.2001 deri më 15.03.2002 dhe nga 15.03.2003 deri më 15.03.2004], për të cilën subjekti ka mundur të paraqesë akte që tregojnë se vëllai i tij ka pasur leje të rregullta qëndrimi si emigrant, janë përfshirë në analizën financiare, por ato janë vetëm 1/4<sup>16</sup> e të gjitha të ardhurave që subjekti ka deklaruar në deklaratat periodike të deklarimit të pasurisë dhe përgjatë procesit të rivlerësimit, të cilat i ka marrë në formën e huadhënies nga vëllai i tij për blerjen e apartamentit me sip. 135 m<sup>2</sup>, në Tiranë. Në këto kushte, për Kolegjin, mbetet i paprovuar ky pretendim i subjektit në këndvështrim të standardeve kushtetuese të provueshmërisë së burimeve të ligjshme të pasurisë, edhe sikur të pranohej se subjekti është financuar në blerjen e apartamentit me huan e marrë prej vëllait të tij.

**16.7** Mbështetur në sa më sipër, Kolegji konstaton se vlera prej 5.900.000 lekësh, e pretenduar prej subjektit si e ardhur e personit tjetër të lidhur, vëllait të tij A. H., nga puna në emigracion, mbetet e pajustificuar në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

**17.** *Kolegji, pasi analizoi pretendimin e subjektit të rivlerësimit për konkluzionet e Komisionit se ka kryer shkelje administrative apo disiplinore pasi nuk ka mundur të provojë mënyrën e pagimit të çmimit të apartamentit, vjen në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike, e konsideroi atë një pretendim jo të drejtë dhe të pabazuar në prova dhe ligj, pasi:*

**17.1** Për këtë shkak ankimi subjekti pretendon se: *Koha shumë e gjatë që ka kaluar nga momenti që unë i kam kryer këto shkelje, edhe sikur t'i marrim të mirëqena se ato kanë ndodhur, në zbatim të parimit të sigurisë juridike dhe të shtetit të së drejtës, e pengon Komisionin që të marrë vendim për shkarkimin tim nga detyra dhe, për këtë arsye, vendimi i tij është marrë në zbatim të gabuar të ligjit dhe, për pasojë, ai është i paligjshëm, në bazë të germës "d" të nenit 109 të Kodit të Procedurave Administrative.*

**17.2** Referuar këtij pretendimi të subjektit të rivlerësimit, Kolegji, duke konsideruar edhe jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese<sup>17</sup>, të parashikimeve të neneve Ç, pika 4 dhe D, pika 1 e

<sup>16</sup> Të ardhurat e personit tjetër të lidhur, vëllait të subjektit të rivlerësimit A. H., sipas deklaratave të lëshuara nga punëdhënësit në Greqi për gjithë periudhën, 1995 – 2006, janë në një shumë totale rreth **11.192.022 lekë**. Nga analiza e kryer vetëm e ardhura prej **1.467.649 lekësh** është e ardhur e krijuar gjatë punësimit përgjatë kohës kur vëllai i subjektit ka qenë i pajisur me leje qëndrimi dhe leje pune, të lëshuara nga organet shtetërore greke, për të cilat rezulton se ka paguar detyrimet tatimore.

<sup>17</sup> Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. 11/2014, ka arsyetuar se: “Gjykata ka theksuar se siguria juridike është ndër elementet thelbësore të shtetit të së drejtës. Kjo siguri presupozon, veç të tjerave, besueshmërinë e qytetarëve tek shteti dhe pandryshueshmërinë e ligjit për marrëdhëniet e rregulluara. Besueshmëria ka të bëjë me faktin se qytetari nuk duhet

Aneksit të Kushtetutës, të zbatueshme në rastin konkret, konstaton se subjekti i rivlerësimit në momentin e lidhjes së kontratës noteriale të shitblerjes së apartamentit me sip. 135 m<sup>2</sup>, ndodhur në Tiranë, ka qenë subjekt deklarues dhe, si i tillë, në zbatim të përcaktimeve të nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003, ka pasur detyrimin të deklaronte burimet e krijimit të pasurisë në momentin e krijimit të saj. Në referim të deklarimit periodik të pasurisë të bërë nga subjekti për vitin 2006, konstatohet që burimet e krijimit të kësaj pasurie të deklaruara në të (kredia dhe huaja e marrë nga vëllai), për shkak të kohës kur subjekti ka disponuar këto burime financimi, që datojnë në janar 2007, logjikisht nuk mund të shërbenin për blerjen e apartamentit me anë të kontratës së shitblerjes së lidhur në datën 12.12.2006 dhe në të cilën palët kishin deklaruar se çmimi ishte likuiduar jashtë zyrës noteriale. Në këto kushte, pretendimi se kontrolli i pasurive të deklaruara në vitin 2006, si pjesë e detyrimeve që vijnë nga mbajtja e funksionit publik dhe vendosja nën kontroll në këtë proces e këtyre deklarimeve, nuk mund të konsiderohet se shkel parimin e sigurisë juridike, pasi pasuritë të cilat janë deklaruar në deklaratën e re *vetting*, janë objekt kontrolli, për të justifikuar ligjshmërinë e burimeve të tyre, duke pasur në konsideratë legjislacionin që ka qenë në fuqi dhe është zbatuar në kuadër të deklarimeve periodike nga subjektet. Përpilimi i një deklarate të re nga subjektet e rivlerësimit në kuadër të dispozitave kushtetuese dhe ligjore që do t'i nënshtrohej verifikimit e kontrollit nga organet e rivlerësimit, u përcaktua të ndodhte në funksion të arritjes së qëllimit për të rikthyer besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, si një qëllim i cili prevalon dhe dominon procesin e rivlerësimit në raport me garancitë e tjera kushtetuese.

**17.3** Në përfundim të shqyrtimit të të gjitha pretendimeve të subjektit në drejtim të burimeve të krijimit të apartamentit prej 135 m<sup>2</sup> në Tiranë, Kolegji arrin në konkluzionin se:

- (i) Nga hetimi administrativ në Komision, nuk provohet se blerja e pasurisë apartament me sip. 135 m<sup>2</sup> nga subjekti i rivlerësimit të jetë krijuar me të ardhurat e marra nga kredia në Raiffaisen Bank dhe nga huaja e vëllait të tij A. H., pasi rezulton se kredia e marrë prej subjektit në janar të vitit 2007, është disbursuar në favor të vëllait të tij A. H.
  - (ii) Për vëllain A. H., nga sa analizuar më sipër, subjekti nuk ka mundur të justifikojë me dokumentacion ligjor burimin e ligjshëm të krijimit të shumës 5,9 milionë lekë që subjekti ka deklaruar se i ka marrë hua për blerjen e kësaj prone, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.
  - (iii) Kryerja e analizës financiare nga Komisioni duke u bazuar në përcaktimet e kontratës së shitblerjes së kësaj prone, lidhur me modalitetet e pagesës, është qëndrim i drejtë, i bazuar në prova dhe ligj.
  - (iv) Kolegji gjen të drejtë qëndrimin e Komisionit se sipas analizës financiare të vitit 2006, subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura të ligjshme për krijimin e pasurisë apartament në Tiranë, duke u gjendur në kushtet parashikuara në nenin 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.
- 18.** Në drejtim të kontrollit të saktësisë dhe vërtetësisë së deklarimeve, Kolegji mori gjithashtu në shqyrtim *pretendimet e subjektit, me anë të të cilave ai kundërshton qëndrimin e Komisionit lidhur me përdorimin prej tij të automjetit e tip Benz, me targa {\*\*\*}, të cilin ai e konsideron se ka ardhur për shkak të vlerësimit të gabuar të gjendjes faktike. Subjekti ka pretenduar se: (i) Kushtetuta e ka lidhur drejtpërdrejt përgjegjësinë e subjektit të vlerësimit me deklaratën *vetting*, tek i cili subjekti ka deklaruar përdorimin e këtij automjeti dhe jo deklarimet në deklarata periodike. (ii) Burimi i ligjshëm i të ardhurave të personit tjetër të lidhur B. H., që kanë shërbyer për blerjen e këtij automjeti, provohet nga aktet e dorëzuara prej subjektit përgjatë hetimit; ndërsa për të vërtetur pagesën e tatimit lidhur me këto të ardhura, subjekti shprehet se e ka të pamundur nga pikëpamja objektive, pasi*

---

*të shqetësohet vazhdimisht për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve normative që cenojnë dhe përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme. Nuk do të kishim të bënim me një rast të garantimit të besueshmërisë në sistemin e normave juridike, nëse siguria lidhur me një situatë të caktuar juridike nuk mund të justifikohet dhe nuk mund të mbrohej materialisht (shih vendimin nr. 26, datë 02.11.2005, të Gjykatës Kushtetuese)”.*

personi tjetër i lidhur ka punuar në emigracion jo në mënyrë të ligjshme ndërsa, për sa u përket të ardhurave të fituara nga personi tjetër i lidhur nga toka bujqësore, duhet të gjejë aplikim neni 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

**18.1** Në analizë të situatës faktike, Kolegji konstaton se nga aktet e administruara, rezulton se subjekti i rivlerësimit në deklaratën *vetting* ka deklaruar përdorimin e automjetit tip Benz {\*\*\*}, në pronësi të kushëririt të tij, shtetasit B. H., në vitet 2013, 2014, 2015 dhe 2016, ndërsa në deklaratat periodike të deklarimit të pasurisë dhe interesave të këtyre viteve, ai nuk e ka deklaruar këtë marrëdhënie.

**18.2** Lidhur me këtë çështje, Komisioni në vendimin e tij ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm, pasi nuk rezulton që ta ketë deklaruar këtë interes privat në deklaratat e interesave privatë periodikë/vjetorë të viteve 2013, 2014, 2015 dhe 2016, sipas germës “a” të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”; subjekti i rivlerësimit nuk provoi me dokumentacion ligjor burimin e ligjshëm të të ardhurave të personit tjetër të lidhur, shtetasit B. H., për blerjen e këtij automjeti nga personi tjetër i lidhur, z. A. H.

**18.3** Kolegji, pasi shqyrtoi pretendimet e subjektit në ankim lidhur me këtë konkluzion të Komisionit, e vlerëson atë të bazuar në ligj. Duke iu referuar përcaktimeve të nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 31 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilave objekt i kontrollit për procesin e rivlerësimit kalimtar është deklarata *vetting*, çmon se për pasojë mangësitë/pasaktësitë e konstatuara në deklaramet periodike nuk mund të shërbejnë për t’u kualifikuar si deklarime të pamjaftueshme në lidhje me kriterin e kontrollit të pasurisë dhe si shkak shkarkimi mbi të cilin të bazohet dhënia e masës disiplinore.

Përpos sa më sipër, lidhur me përdorimin e automjetit tip Benz, me targa {\*\*\*}, meqenëse subjekti ka deklaruar përdorimin e automjetit në pronësi të kushëririt të tij, B. H., Komisioni e ka konsideruar këtë të fundit si person tjetër i lidhur në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 dhe nuk rezulton që Komisioni të ketë ngritur ndaj subjektit ndonjë dyshim apo të ketë kaluar barrë prove për ndonjë rrethanë që mund të çonte te hipoteza e një pasurie të fshehur të subjektit. Në këto kushte, referuar edhe jurisprudencës së deritanishme të Kolegjit, sipas së cilës: *Në analizë të fakteve dhe rrethanave lidhur me përdorimin prej subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të të apartamentit të babait të tij, z. M.K., pa pagesë qiraje, trupi gjykues, edhe pse mban në konsideratë faktin që mbështetja që i është dhënë subjektit të rivlerësimit nga babai i tij, z. M.K., si më sipër, mund të trajtohej teorikisht si një përfitim monetar (shumë e pashpenzuar për qëllime qiraje banimi) dhe, si rrjedhojë, do të mund të vendoste palët në një marrëdhënie interesi pasuror sipas parashikimeve të nenit 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016, arrin në përfundimin se nëse gjatë kontrollit të kësaj pasurie nuk arrihet në një konkluzion në kuadër të nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, në drejtim të tentativës për të fshehur pasurinë (duke qenë se për shkak të marrëdhënies së ngushtë familjare dyshimi për konflikt të mundshëm interesi nuk ekziston), atribuimi i mungesës së burimeve të ligjshme të babait të subjektit, për të justifikuar krijimin e pasurisë së paluajtshme apartament me sip. 135 m<sup>2</sup> dhe dy garazhe me sip. 18 m<sup>2</sup>, subjektit të rivlerësimit, në kuadër të lidhjes që ekziston mes tyre për përdorim të përbashkët të banesës, pa qira, do të tejkalojë objektin e procesit të rivlerësimit<sup>18</sup> – përcaktimet e pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 gjejnë aplikim vetëm në rastet kur midis subjektit e personit tjetër të lidhur ekziston një marrëdhënie huadhënieje, huamarrjeje apo dhurimi, e cila do të detyronte subjektet e rivlerësimit dhe personat e tjerë të lidhur, të justifikojnë ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë në transaksion.*

Përdorimi i automjetit, si një marrëdhënie huapërdorjeje del jashtë kategorisë së marrëdhënieve të cilat do ta vendosnin shtetasin B. H. në statusin e personit tjetër të lidhur, në kuptim të nenit 32, pika

<sup>18</sup> Shih vendimin: <http://kpa.al/wp-content/uploads/2020/09/Vendimi-Sh-Kurti-i-anonimizuar-per-web.pdf>.

4 e ligjit nr. 84/2016 dhe, për pasojë, ky fakt nuk mund të ngarkojë subjektin e rivlerësimit me detyrimin për të provuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë automjet.

**18.4** Bazuar në këtë arsyetim, Kolegji nuk e konsideron të mbështetur në ligj qëndrimin dhe konkluzionet e Komisionit lidhur me të drejtën e përdorimit të këtij automjeti prej subjektit të rivlerësimit, lidhur me pasaktësitë në deklaratat periodike, si edhe atë lidhur me pamundësinë e provimit të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë automjet nga z. B. H.

- 19.** Kolegji mori në shqyrtim *pretendimin e subjektit lidhur me kursimet në cash, për të cilat ai pretendon se Komisioni ka kryer shkelje ligjore që lidhen me vlerësimin e gabuar të gjendjes faktike për gjendjen e tyre pasi: (i) Mosdeklarimi i kursimeve cash nga ana e subjektit për vitet 2003 e 2004 në deklaratat periodike ka ndodhur për shkak të moskuptimit të deklaratave periodike. (ii) Duke qenë se shumat e deklaruara si kursime cash në DVP kanë gabime dhe pasaktësi si shumë e kursyer prej subjektit deri në vitin 2016 duhet të konsiderohet shuma e deklaruar në deklaratën vetting.*

**19.1** Lidhur me kursimet në *cash* në vendimin e Komisionit objekt shqyrtimi, është konkluduar se: *Nga analiza e dokumentacionit të administruar në dosje, nga deklaratimet e dhëna dhe provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni arrin në konkluzionin se:*

- (i) Subjekti ka kryer deklarim të pasaktë të kursimeve cash në deklaratat periodike të vitit 2003 dhe 2004.*
- (ii) Subjekti ka deklaruar në mënyrë të pamjaftueshme kursimet e tij cash në deklaratën “vetting”.*

**19.2** Nga analizimi i vendimit të Komisionit, Kolegji konstaton ndër të tjera, se për kursimet në *cash* shprehet: *Subjekti deklaroi për herë të parë gjendjen e likuiditeteve cash në vitin 2005, duke saktësuar në deklaratimin e këtij viti se kjo gjendje e ka burimin nga likuiditetet në vitet 2003 dhe 2004.*

**19.3** Nga analizimi i deklaratimeve periodike të subjektit, konstatohet se në DVP-të e viteve 2003 dhe 2004, subjekti nuk ka deklaruar kursime *cash* dhe se ka deklaruar në DVP-në e vitit 2005 shumën 550.000 lekë si kursim në *cash*, duke e përkufizuar atë se është e kursyer nga paga dhe puna 6-vjeçare si gjyqtar dhe pedagog, me shënimin se kjo shumë nuk është deklaruar më parë pasi ajo ka qenë nën kufirin 5000 USD, të përcaktuar nga pika 2 e deklaratës.

**19.4** Ky deklarim ka pësuar ndryshim prej subjektit në deklaratimet që ai bëri në përgjigje të pyetësorëve nr. 2 dhe nr. 3 përgjatë hetimit administrativ në Komision, me atë të cilave ai pretendon se gjendja e likuiditeteve *cash* në fund të çdo viti, respektivisht për periudhën 2003 – 2005, ka qenë për vitin 2003 në shumën 300.000 lekë; për vitin 2004 në shumën 400.000 lekë dhe për vitin 2005, gjendja e likuiditeteve *cash* ka qenë 400.000 lekë. Sipas këtij deklarimi të subjektit, të bërë në përgjigje të pyetësorit nr. 2 të Komisionit, totali i *cash*-it në vitin 2005 duhet të kishte qenë në vlerën 1.100.000 lekë.

**19.5** Në analizë të këtij shpjegimi të subjektit përgjatë hetimit në Komision, Kolegji konstaton se subjekti tenton të përfshijë në analizën e viteve 2003 e 2004 kursime në *cash*, të cilat nuk i ka deklaruar në DVP-të e këtyre viteve, që në total tejkalojnë edhe vlerën e deklaruar si kursim prej vetë subjektit si *cash* i akumuluar në DVP-në 2005, i cili deklarohet në këtë deklaratë se është krijuar në një periudhë 6-vjeçare kursimesh. Gjithashtu, referuar këtij shpjegimi të pyetësorit nr. 2, vërehet se edhe për vitin 2005, subjekti ndryshon vlerën e kursimeve *cash* të deklaruar në DVP-në e këtij viti, nga 550.000 lekë në 400.000 lekë.

**19.6** E gjithë kjo situatë e përshkruar më sipër lidhur me deklaratimet e kursimeve *cash* në DVP-të e viteve 2003, 2004 e 2005 dhe ato të deklaruara si kursime në *cash* përgjatë hetimit administrativ nga Komisioni, është konsideruar si “pasaktësi” në deklaratimet në DVP-të e viteve 2003 e 2004, duke qenë se referuar përmbajtjes së këtyre deklaratave vjetore periodike, subjekti nuk ka deklaruar fare kursime në *cash* në këto vite.

**19.7** Lidhur me kursimet në *cash*, nga analiza e financiare e kryer në Kolegji, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi për të krijuar kursimet e deklaruara prej tij në DVP-në 2005, në shumën 550.000 lekë, si likuiditet *cash* i akumuluar i viteve të mëparshme. Për sa më sipër, Kolegji, nisur nga mungesa e deklarimeve për gjendje *cash*-i në deklaratat periodike të viteve 2003 e 2004, në analizën financiare mori në konsideratë vetëm vlerën e deklaruar si të tillë në DVP-në e vitit 2005, në shumën 550.000 lekë, të cilën, referuar kësaj analize, subjekti rezulton se kishte mundësi ta krijonte në atë kohë me burime të ligjshme.

Kolegji vlerëson se me të drejtë Komisioni nuk ka konsideruar si gjendje *cash* vlerën prej 1.100.000 lekësh, të pretenduar nga subjekti në vitin 2005, për sa kohë që prova me shkresë, deklaratat periodike të viteve 2003 e 2004, në kuptim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, nuk japin këtë informacion rreth këtij fakti.

Në vijim të këtij arsyetimi, duket se deklaratimet e subjektit përgjatë hetimit administrativ për gjendje të *cash*-it të padeklaruara më parë në deklaratat periodike përkatëse, janë bërë në vlera të tilla që të justifikojnë krijimin e shumës 1,5 milionë lekë në dhjetor të vitin 2006, me qëllimin për të justifikuar aftësinë likuiduese të subjektit për një pjesë të çmimit të blerjes së apartamentit me sip. 135 m<sup>2</sup> në Tiranë.

**19.8** Gjithashtu, brenda kontekstit të këtij shkakut ankimi, Kolegji mori në shqyrtim edhe pretendimin e subjektit lidhur me shumën e deklaruara si *cash* deri në vitin 2016, me anë të të cilit ai pretendon se shuma që duhet të merret në analizë si likuiditet *cash*, duhet të jetë ajo e deklaruar prej tij në deklaratën *vetting* (prej 600 000 lekësh) dhe jo shumatorja e shifrave të deklaruara në deklaratat periodike vjetore, e përlllogaritur nga Komisioni në shumën 3 300 000 lekë.

**19.9** Në vijim të shqyrtimit të këtij shkakut ankimi, rezulton se lidhur me deklaratimet e kursimeve *cash* në vite, në vendimin e Komisionit arsyetohet se: [...] Komisioni çmon se pas përgjigjeve të pyetësorit të 2-dytë dhe të 3-tretë, në të cilin subjekti i rivlerësimit ka ndryshuar tërësisht qëndrimin e tij lidhur me kursimet *cash*, subjekti nuk arriti të provojë me dokumente provues gjendjen e kursimeve *cash* në fund të çdo viti. Në vlerësim të Komisionit u mor në konsideratë vetëm deklarimi i bërë në vitin 2008, ku subjekti deklaroi vlerën 1.500.000 lekë dhe që u konsiderua si deklarim i vlerës në monedhën “lekë të vjetër”.

[...] Nisur nga këto deklarime, duket se gjendja e kursimeve *cash* të deklaruara prej subjektit të rivlerësimit deri në fund të vitit 2016 në total rezulton të jetë 3.330.000 lekë ndërkohë që në deklaratën “*vetting*”, subjekti ka deklaruar kursime jashtë sistemit bankar në shumën 600.000 lekë.

**19.10** Në vlerësim të situatës së mësipërme, Kolegji, pasi analizoi deklaratat periodike të pasurisë të subjektit të rivlerësimit, si dhe deklaratën *vetting* konstaton se:

- Në DVP-në e vitit 2008, subjekti ka deklaruar: *Shtim pasurie në të holla nga të ardhurat nga paga e punës si gjyqtar dhe shpërblimet në honorarë si pedagog i jashtëm i një universiteti jopublik, vlera 1 500 000 lekë.*

- Në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar: *Shumë parash e kursyer nga paga si gjyqtar dhe si pedagog i jashtëm në {\*\*\*}, Tiranë, të cilën e kam në pronësi në momentin e deklarimit dhe e disponoj jashtë sistemit bankar, vlera 600 000 lekë .*

**19.11** Në analizë të sa më sipër, Kolegji, referuar analizës financiare të kryer nga Komisioni, konstaton se vlera prej 3.330.000 lekësh e kursimeve në *cash* të identifikuar në vendimin e Komisionit është në këtë masë duke llogaritur, ndër të tjera, si kursimet në *cash* për vitin 2008 shumë prej 1.500.000 lekësh dhe jo shumë prej 150.000 lekësh, siç ka pranuar të korrigjojë vetë Komisioni në vendimin e tij. Pra, rezulton se Komisioni nuk ka reflektuar në analizën financiare dhe në konkluzionin e tij rreth gjendjes së likuiditeteve në *cash*, qëndrimin e tij të mbajtur lidhur me shumë prej 1.500.000 lekësh, të deklaruara si gjendje *cash* në vitin 2008 dhe të pranuar prej Komisionit se janë në vlerën prej 150.000 lekësh. Kolegjit, pasi reflektoi këtë defekt të Komisionit në analizën financiare të kryer, i rezultoi se gjendja e këtij zëri në datën 31.12.2006, do të duhej të ishte llogaritur në vlerën e 1.980.000 lekëve, ndërkohë që vetë subjekti, në shpjegimet e pyetësorëve<sup>19</sup>, si dhe në shpjegimet e seancës dëgjimore<sup>20</sup> ka pretenduar se vlera e akumuluar në këtë datë është 600 000 lekë, e cila i korrespondon vlerës së deklaruar si likuiditeti në *cash* në deklaratën *vetting*.

**19.12** Bazuar në sa më sipër, Kolegji konstaton se e gjithë kjo situatë faktike evidenton pasaktësi të deklaramëve periodike të subjektit lidhur me deklarimin e shtimit dhe të pakësimit të kursimeve në *cash*, por nga ana tjetër, referuar shifrave të deklaruara në DVP si kursime në *cash* dhe analizës financiare të kryer, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë qenë në pamundësi financiare për të krijuar këto kursime. Në këtë kuptim, shumë e deklaruar si kursime në *cash* në deklaratën *vetting*, subjekti e justifikon me burime të ligjshme. Referuar edhe sa shprehur më sipër për pasaktësitë në deklaramet periodike të konstatuara për kursimet në *cash*, duke qenë se në çdo version të pretenduar nga subjekti, atë të deklaruar në deklarata periodike apo ato të deklaruara në përgjigje të pyetësorëve, nga analiza financiare rezulton se ai ka burime financiare për të justifikuar këto pasuri në secilin vit, Kolegji çmon se këto pasaktësi që lidhen me deklarimin e saktë të shtesave apo pakësimeve të likuiditeteve në *cash*, nuk mund të ngrihen në nivelin e një shkaku shkarkimi<sup>21</sup>.

Për këtë arsye, konkluzionin e Komisionit se subjekti ka deklaruar në mënyrë të pamjaftueshme kursimet e tij *cash* në deklaratën “*vetting*”, për sa kohë që ai justifikon me burime të ligjshme çdo vlerë *cash* të deklaruar në deklarata periodike, apo në përgjigje të pyetësorëve, si edhe atë të deklaruar në deklaratën *vetting*, Kolegji e konsideron të paargumentuar dhe të pabazuar në prova e ligj.

- 20.** Lidhur me pretendimin e subjektit se Komisioni ka kryer vlerësim të gabuar të gjendjes së faktit për detyrimin financiar ndaj shtetasit R. K., pasi ai gjatë hetimit administrativ dhe në seancë dëgjimore ka paraqitur dokumentacion që provon se ky shtetas i ka dhënë këtë hua me para, të cilat i ka siguruar nga puna e tij e rregullt në Greqi, Kolegji, pasi e vlerësoi, e konsideroi jorelevant dhe të paarsyeshëm

<sup>19</sup> Në përgjigjet e pyetësorit 3, subjekti ka shpjeguar se vlerat në *cash* për periudhën 2007-2015 pjesërisht janë kursyer duke u mbajtur në gjendje *cash* e pjesërisht janë përdorur për shlyerjen e pjesës së detyrimit të huas ndaj vëllait A. Pas shlyerjes së një pjese të huas ndaj vëllait, subjekti ka deklaruar se në fund të vitit 2016, ka pasur gjendje në *cash* një vlerë prej 600 000 lekësh.

<sup>20</sup> Në seancën dëgjimore të zhvilluar nga Komisioni, subjekti ka shpjeguar se shuma e deklaruar si gjendje *cash* në fund të vitit 2016 deklaruar në *vetting*, është deklarimi i saktë dhe që përputhet me realitetin.

<sup>21</sup> Shih vendimin e Kolegjit nr. 28/2020 (JR), datë 23.10.2020, që i përket subjektit të rivlerësimit Fuat Vjerdha.

për sa kohë që konkluzioni i Komisionit lidhur me këtë çështje nuk ka prodhuar ndonjë pasojë në raport me vendimmarrjen e tij ndaj subjektit.

**20.1** Lidhur me këtë shkak ankimi, referuar vendimit të Komisionit objekt shqyrtimi, si dhe akteve të administruara përgjatë hetimit administrativ, ka rezultuar se në DVP-në e vitit 2014, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar një detyrim financiar ndaj shtetasit R. K., në vlerën 40.000 USD, sipas kontratës së huas nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 16.01.2014, të depozituar nga huadhënësi R. K. në Intesa Sanpaolo Bank, më datë 17.01.2014. Kjo shumë është përdorur nga subjekti si garanci financiare në procedurën për marrjen e vizës nga Ambasada e ShBA-së. Në të njëjtën deklaratë periodike, subjekti ka deklaruar gjithashtu shlyerjen e detyrimit ndaj shtetasit R. K. në shumën 40.000 USD, në bazë të deklaratës noteriale nr. {\*\*\*} rep., e nr. {\*\*\*} kol., datë 22.02.2014, duke tërhequr këtë shumë nga llogaria në Intesa Sanpaolo Bank më datë 21.02.2014, për shkak të refuzimit të vizës amerikane dhe kthimin e saj te huadhënësi.

**20.2** Në vendimin e Komisionit për këtë hua të marrë prej subjektit nga shtetasi R. K., është konkluduar se *subjekti nuk provoi me dokumentacion ligjor burimin e ligjshëm të krijimit të të ardhurave dhe transferimin e tyre te subjekti i rivlerësimit pavarësisht se analiza e burimit të ligjshëm nuk ka efekt në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit, pasi huaja e deklaruar nuk është përdorur prej tij si burim për blerje pasurie.*

**20.3** Në analizë të situatës faktike dhe akteve të administruara përgjatë hetimit administrativ, në këtë rast konstatohet se midis subjektit dhe z. R. K. ka pasur një marrëdhënie huamarrjeje afatshkurtër, për një shumë prej 40.000 USD, e cila ka shërbyer si garanci financiare në funksion të marrjes së vizës për në ShBA prej subjektit dhe bashkëshortes. Specifika e rastit konkret ka provuar se nga kjo marrëdhënie huamarrjeje nuk konstatohet që subjekti të ketë realizuar shtim apo pakësim të pasurisë së tij dhe as konstatohet që kjo hua të ketë ndikuar në ndonjë farë mënyre analizën financiare të kryer nga Komisioni në kuadër të procesit të rivlerësimit. Në këto kushte, Kolegji çmon se, referuar konkluzioneve të Komisionit në rastin konkret, në drejtim të kontrollit të kriterit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, nuk rezulton që këtij fakti t'i jetë dhënë ndonjë peshë në drejtim të vlerësimit të kriterit të pasurisë, por ka nënvizuar faktin se kjo marrëdhënie, pavarësisht konkluzionit të arritur në lidhje me burimet e ligjshme të krijimit të shumës së dhënë hua nga z. R. K., nuk ka afektuar analizën financiare të subjektit, duke lënë pa pasojë në vlerësimin e këtij kriteri konkluzionin e arritur sa më sipër.

Në këtë kuptim, Kolegji konstaton se Komisioni nuk ka përdorur aplikimin e nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 lidhur me këtë marrëdhënie dhe as e ka veshur atë me pasoja për subjektin në procesin e tij të rivlerësimit, për sa kohë që shuma e marrë hua nuk ka shërbyer për shtimin apo krijimin e ndonjë pasurie për subjektin e rivlerësimit dhe as për përballimin e ndonjë shpenzimi të kryer prej tij.

**20.4** Për sa më sipër, Kolegji e konsideron si jorelevant pretendimin e subjektit për qëndrim të gabuar të Komisionit lidhur me burimet e ligjshme të krijimit të shumës së dhënë hua prej shtetasit R. K., për sa kohë që qëndrimi rreth burimeve të ligjshme të krijimit të kësaj huaje nuk rezulton të ketë pasur asnjë efekt mbi pasuritë e krijuara nga subjekti i rivlerësimit dhe, për pasojë, ai nuk është përfshirë si një konkluzion lidhur me vlerësimin e kontrollin e kriterit të pasurisë.

**21.** *Kolegji mori gjithashtu në shqyrtim edhe shkakun e ankimit që i referohej pretendimit të subjektit se dhënia e masës disiplinore të shkaktimit të tij nga detyra është ndikuar nga roli i tij aktiv në qëndrimin*

*që ka mbajtur lidhur me reformën në drejtësi, si dhe në emisionet e medias vizuale të cilat kanë pasqyruar së shumti qëndrimet oponente të subjektit për këtë reformë.*

**21.1** Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti, së bashku me ankimin, ka paraqitur si provë akte me anë të të cilave synonte të provonte pretendimin e tij për pjesëmarrjen e tij aktive në diskutimet rreth hartimit e miratimit të reformës në drejtësi<sup>22</sup>.

**21.2** Në vlerësim të këtij pretendimi të subjektit të rivlerësimit, Kolegji çmon të nënvizojë faktin se nuk gjendet asnjë gjurmë në aktet e administruara në fashikull apo e dhënë në vendimin e Komisionit apo në qëndrimet e anëtarëve të trupës gjyquese në Komision, që të hedhë dyshime se qasja e tyre në vlerësimin e procesit të rivlerësimit për subjektin ka qenë e ndikuar nga qëndrimet e tij publike të çfarëdo natyre qofshin. Siç është pasqyruar gjerësisht në arsyetimin e këtij vendimi, masa disiplinore për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit është dhënë mbështetur në konkluzionet mbi kontrollin e kriterit të pasurisë, pasi subjekti ka rezultuar se nuk ka mundur të provojë burimet e ligjshme të krijimit të pasurisë së tij. Për më tepër, ky vendim është gjetur i drejtë nga Kolegji në elementet thelbësore të tij, që motivojnë dhe mbështesin konkluzionin për dhënien e masës disiplinore ndaj subjektit të rivlerësimit, duke përjashtuar edhe për shkak të këtij kontrolli kushtetues, konkluzionin se ai ka qenë i ndikuar nga faktorë të ndonjë natyre tjetër.

**21.3** Në këto kushte, Kolegji çmon se ky pretendim i subjektit gjendet tërësisht jo i lidhur me përmbajtjen dhe arsyetimin e vendimit që subjekti kundërshton, si dhe i paargumentuar në prova dhe në ligj.

- 22.** Për sa më sipër, Kolegji, pasi analizoi shkaqet e parashtruara në ankim, si dhe parashtrimet e subjektit të rivlerësimit kundër vendimit të Komisionit objekt shqyrtimi, si dhe pasi analizoi dhe vlerësoi të gjitha provat dhe aktet e administruara për këtë çështje gjatë hetimit administrativ, arriti në konkluzionin se vendimi nr. 170, datë 26.06.2019, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, është një vendim i drejtë, i bazuar në fakte e në ligj, i cili mbështetet në mënyrë të përmbledhur në konkluzionin si më poshtë.
- 23.** Subjekti gjendej në pamundësi për të financuar me burime të ligjshme krijimin e pasurisë apartament në vitin 2006, qoftë sikur të përdorte për blerjen e saj fondet financiare në pronësi të tij, por edhe sikur të përdorte huan e deklaruar se është marrë prej vëllait të tij A. H., duke qenë se nuk provohet burimi i ligjshëm i krijimit të shumës prej 5.900.000 lekësh në secilën prej këtyre alternativave. Për pasojë, Kolegji çmon se ai gjendet në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 dhe, në vlerësimin tërësor të këtij kriteri, konkludon se ai gjendet para situatës që parashikon neni 61, pika 3 e po këtij ligji, në zbatim të të cilit është vendosur me të drejtë prej Komisionit, shkarkimi i tij nga detyra.

---

<sup>22</sup> Aktet e paraqitura nga subjekti me ankimin, në mbështetje të këtij pretendimi, janë :

- një kopje e CD-së, e cila në përmbajtjen e saj ka intervistën e dhënë nga ana subjekti në televizionin kombëtar {\*\*\*}, në vitin 2015;
- një kopje e faqes së web-it të televizionit {\*\*\*}, me titull: "Reforma në drejtësi, flet Luan Hasneziri";
- një kopje e shkrimit në faqen e portalit të njohur on line "{\*\*\*}", me titull: "Kundërshtoi hetimin e pasurisë/Gjyqtari i Krimeve te Renda ne "ethe" nga vettingu".



24. Në vlerësim dhe analizë të konkluzionit të mësipërm, Kolegji arrin në përfundimin se subjekti, i gjendur në situatat e mësipërme të shkeljes së ligjit, nuk arrin të plotësojë kriteret kushtetuese për arritjen e një niveli të besueshëm në drejtim të kontrollit të kriterit të pasurisë sipas kërkesave të nenit D, pikat 1, 3 e 5 të Aneksit të Kushtetutës duke u kualifikuar në kushtet e një deklarimi të pamjaftueshëm në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, si një kondicion ligjor për shkarkimin e tij nga detyra. Për pasojë, vendimi nr. 170, datë 26.06.2019, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është marrë në zbatim të ligjit e mbështetur në prova dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

### **PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **VENDOSI:**

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 170, datë 26.06.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që i përket subjektit të rivlerësimit Luan Hasneziri.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, më datë 28.07.2021.

#### **ANËTARE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*

#### **ANËTARE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*

#### **ANËTAR**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi*

#### **RELATORE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*

#### **KRYESUES**

**Ardian HAJDARI**

*nënshkrimi*